

MONITORIMI I TRANSPARENCËS SË GJYKATAVE

MANUAL TRAJNIMI PËR SHOQËRINË CIVILE

Disponueshmëria e vendimeve gjyqësore
dhe aksesit në dokumentet e gjykatës.
Praktikat e transparencës në funksionimin
e brendshëm të gjykatës

Manual 2

Tiranë, Shtator 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

©Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: 9789928361653

SHKURTIME

APKB	Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
DUDNj	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
Deklarata e Stambollit	Deklarata e Stambollit për Transparencën në Procesin Gjyqësor
GjEDNj	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
GjK	Gjykata Kushtetuese
ILD	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
NjABGj	Njësia e administrimit të buxhetit gjyqësor, pranë KLGj-së
NMMP	Nëpunësi për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun
PNDCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (International Covenant on Civil and Political Rights)
ENCJ/RREKGj	Rrjeti Europian i Këshillave Gjyqësorë
GJIN/RRBIGj	Rrjeti Botëror i Integritetit Gjyqësor (Global Judicial Integrity Network)
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (The European Convention on Human Rights)
KKBK	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
KLGj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
CCJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europianë
KPC	Kodi i Procedurës Civile
KPP	Kodi i Procedurës Penale
ShM	Shkolla e Magjistraturës

PASQYRA E LËNDËS

SHKURTIME	3
I. HYRJE	9
II. OBJEKTIVAT & REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET	10
III. PLANI I TRAJNIMIT	11
IV. MONITORIMI I DISPONUESHMËRISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE CIVILE	14
IV.1 FAKTORI 1 - INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR INFORMIMIN	
MBI VENDIMET GJYQËSORE	14
IV.1.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	14
IV.1.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	16
IV.1.3 METODA E MATJES	16
IV.2 FAKTORI 2 - SHPALLJA DHE PUBLIKIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE.....	17
IV.2.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	17
IV.2.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	17
IV.2.3 METODA E MATJES.....	18
IV.3 FAKTORI 3 – KORRIGJIMI I GABIMEVE NË VENDIM DHE INTERPRETIMI I TIJ.....	18
IV.3.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	18
IV.3.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	18
IV.3.3 METODA E MATJES.....	19
IV.4 FAKTORI 4 – KOHA PËR DISPONUESHMËRINË E VENDIMEVE	19
IV.4.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	19
IV.4.2 TREGUESIT E REALIZIMIT.....	19
IV.4.3 METODA E MATJES.....	20
IV.5 FAKTORI 5 - LEHTËSIA E KËRKIMIT NË BAZAT E TË DHËNAVE PËRKATËSE	
NGA PUBLIKU I GJERË	20
IV.5.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	20
IV.5.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	21
IV.5.3 METODAT E MATJES	21
V. 6 FAKTORI 6 - PËRMBLEDHJE E ECURISË SË RASTEVE DHE / OSE KRONOLOGJIA	
E RASTEVE.....	21
IV.6.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	21
IV.6.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	22
IV.6.3 METODA E MATJES	22

V. MONITORIMI I DISPONUESHMËRISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE.....	24
V.1 FAKTORI 1 - INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR INFORMIMIN	
MBI VENDIMET GJYQËSORE.....	24
V.1.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	24
V.1.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	26
V.1.3 METODA E MATJES	26
V.2 FAKTORI 2 - SHPALLJA DHE PUBLIKIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE	27
V.2.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	27
V.2.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	27
V.2.3 METODA E MATJES	28
V.3 FAKTORI 3 – KORRIGJIMI I GABIMEVE NË VENDIM DHE INTERPRETIMI I TIJ	28
V.3.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	28
V.3.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	28
V.3.3 METODA E MATJES	29
V.4 FAKTORI 4 - KOHA PËR DISPONUESHMËRINË E VENDIMEVE	29
V.4.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	29
V.4.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	30
V.4.3 METODA E MATJES	30
V.5 FAKTORI 5 - LEHTËSIA E KËRKIMIT NË BAZAT E TË DHËNAVE PËRKATËSE	
NGA PUBLIKU I GJERË	30
V.5.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	30
V.5.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	31
V.5.3 METODAT E MATJES.....	31
V. 6 FAKTORI 6 – PËRMBLEDHJE E ECURISË SË RASTEVE DHE / OSE KRONOLOGJIA	
E RASTEVE.....	31
V.6.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	31
V.6.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	32
V.6.3 METODA E MATJES	32
VI. MONITORIMI I DISPONUESHMËRISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE	
ADMINISTRATIVE.....	34
VI.1 FAKTORI 1 - INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR INFORMIMIN MBI	
VENDIMET GJYQËSORE	34
VI.1.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	34
VI.1.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	36
VI.1.3 METODA E MATJES	36
VI.2 FAKTORI 2 - SHPALLJA DHE PUBLIKIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE	36
VI.2.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	36
VI.2.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	37
VI.2.3 METODA E MATJES	37
VI.3 FAKTORI 3 – KORRIGJIMI I GABIMEVE NË VENDIM DHE INTERPRETIMI I TIJ	38
VI.3.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	38

VI.3.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	38
VI.3.3 METODA E MATJES	38
VI.4 FAKTORI 4 – KOHA PËR DISPONUESHMËRINË E VENDIMEVE	38
VI.4.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	38
VI.4.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	39
VI.4.3 METODA E MATJES	39
VI.5 FAKTORI 5 - LEHTËSIA E KËRKIMIT NË BAZAT E TË DHËNAVE PËRKATËSE NGA PUBLIKU I GJERË	40
VI.5.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	40
VI.5.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	40
VI.5.3 METODAT E MATJES.....	41
VI. 6 FAKTORI 6 - PËRMBLEDHJE E ECURISË SË RASTEVE DHE / OSE KRONOLOGJIA E RASTEVE.....	41
VI.6.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	41
VI.6.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	41
VI.6.3 METODA E MATJES	42
VII. MONITORIMI I TË DREJTËS PËR AKSES NË DOKUMENTET DHE NË DOSJET E GJYKATËS PËR PALËT NË GJYKIM DHE PALËT E INTERESUARA.....	43
VII.1 FAKTORI 1 - QASJA NË INFORMACIONIN PUBLIK DHE TRANSPARENCA NË GJYQËSOR.....	43
VII.1.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	43
VII.1.2 TREGUESIT E REALIZIMIT.....	44
VII.1.3 METODA E MATJES.....	45
VII.2 FAKTORI 2 - TRANSPARENCA DHE PAVARËSIA GJYQËSORE	45
VII.2.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	45
VII.2.2 TREGUESIT E REALIZIMIT.....	47
VII.2.3 METODA E MATJES.....	49
VII.3 FAKTORI 3 - AKSESI NË INFORMACIONIN PUBLIK NË GJYKATA	49
VII.3.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	49
VII.3.2 TREGUESIT E REALIZIMIT.....	50
VII.3.3 METODA E MATJES.....	50
VII.4 FAKTORI 4 - MONITORIMI I CAKTIMIT TË ÇËSHTJEVE PËR GJYQTARË	50
VII.4.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	50
VII.4.2 TREGUESIT E REALIZIMIT.....	51
VII.4.3 METODA E MATJES.....	53
VIII. MONITORIMI I AKSESIT NË INFORMACION DHE PRAKTIKAT E TRANSPARENÇËS NË FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM DHE ASPEKTET ADMINISTRATIVE TË GJYQËSORIT.....	54
VIII.1 FAKTORI 1 - INFORMACION MBI MENAXHIMIN E FONDEVE PUBLIKE (BUXHETET, SHPENZIMET PROKURIMI).....	54

VIII.1.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	54
VIII.1.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	55
VIII.1.3 METODAT E MATJES.....	57
VIII.2 FAKTORI 2 - INFORMACION MBI EMËRIMIN DHE STRUKTURËN E PAGAVE TË GJYQTARËVE.....	58
VIII.2.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	58
VIII.2.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	59
VIII.2.3 METODA E MATJES	59
VIII.3 FAKTORI 3 - AKSESI NË INFORMACION DHE PRAKTIKAT E TRANSPARENCËS LIDHUR ME FUNKSIONET JURIDIKSIONALE TË GJYQËSORIT	60
VIII.3.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	60
VIII.3.2 TREGUESIT E REALIZIMIT	62
IX. MONITORIMI I TË DREJTËS PËR AKSES NË VENDIMET DHE PRAKTIKAT E GJYKATËS SË LARTË PËR PALËT NË GJYKIM DHE PALËT E INTERESUARA.....	63
IX.1 FAKTORI 1 - PUBLIKIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS SË LARTË.....	63
IX.1.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	63
IX.1.2 TREGUESIT E REALIZIMIT.....	64
IX.1.3 METODA E MATJES	64
IX.2 FAKTORI 2 - TRANSPARENCA MBI PUNËN E GJYKATËS SË LARTË NË DHOMA KËSHILLIMI.....	64
IX.2.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	64
IX.2.2 TREGUESIT E REALIZIMIT.....	65
IX.2.3 METODAT E MATJES.....	65
IX.3 FAKTORI 3 - TRANSPARENCA NË SEANCAT E KOLEGJEVE TË GJYKATËS SË LARTË.....	66
IX.3.1 STANDARDI I PERFORMANCËS	66
IX.3.2 TREGUESIT E REALIZIMIT.....	67
IX.3.3 METODAT E MATJES.....	68
X. EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI	68
XI. RASTE STUDIMORE.....	71
XII. BIBLIOGRAFIA	74

I. HYRJE

Manuali i dytë i Trajnimit mbi “*Monitorimin e transparencës së gjykatave*” vjen si një vijimësi e Guidës së Monitorimit për Shoqërinë Civile “*Transparenca e gjykatave*”, qëllimi final i së cilës është monitorimi i respektimit të standardeve të transparencës nga ana e gjykatave.

Ky qëllim pritet të arrihet përmes monitorimit të jashtëm, të pavarur dhe profesional nga ana e shoqërisë civile dhe grupet e shënjestruara: organizatat e shoqërisë civile, studentët e drejtësisë dhe gazetarët.

Në vijim të treguesve dhe faktorëve të përcaktuara në Guidë, nëpërmjet këtij manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha elementet dhe standardet që duhet të zbatohen për monitorimin, duke u ndalur në këto elemente kryesore:

1. Disponueshmëria e vendimeve gjyqësore.
2. E drejta për akses në dokumentet dhe në dosjet e gjykatës për palët në gjykim dhe palët e interesuara.
3. Aksesimi në informacion dhe praktikën e transparencës në funksionimin e brendshëm dhe aspektet administrative të gjyqësorit.

Do të merren në analizë aktet ndërkombëtare dhe kuadri ligjor i brendshëm, me qëllim dhënien e një tabloje të plotë të nivelit të garantimit të transparencës gjyqësore në Shqipëri, si dhe do të ofrohen treguesit të cilave u duhet bërë referim (standardi, treguesi i realizimit dhe metoda e matjes) për monitorimin e mënyrës së zbatimit dhe respektimit të këtij parimi të rëndësishëm në Shqipëri.

II. OBJEKTIVAT & REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET

Ky manual ka për qëllim aftësimin e aktorëve të shoqërisë civile, studentëve të drejtësisë, gazetarëve dhe thellimin e njohurive të tyre mbi monitorimin e aktivitetit të gjykatave sipas standardeve të zbatueshme për sa i përket transparencës gjyqësore.

Manuali ka për qëllim:

- Të ofrojë njohuri mbi standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të brendshëm, për sa i përket transparencës gjyqësore;
- Të ofrojë njohuri mbi institucionet/aktorët përgjegjës për respektimin e transparencës gjyqësore;
- Të ofrojë njohuri mbi indikatorët apo treguesit e realizimit të monitorimit dhe se si ato mund të përdoren dhe maten;
- Nëpërmjet ndërthurjes së metodës teorike me shpjegimet praktike, do të synojmë aftësimin dhe rritjen e kapacitetit të aktorëve të shoqërisë civile, studentëve të drejtësisë, gazetarëve për zbatimin dhe monitorimin e këtyre parimeve.

Në përfundim të këtij manuali aktorët e shoqërisë civile, studentët e drejtësisë, gazetarët do të kenë aftësitë e duhura për monitorimin e respektimit të parashikimeve ligjore që lidhen me transparencën e gjykatave, duke analizuar standardet e performancës të parashikuara në ligj dhe duke pasqyruar treguesit e realizimit dhe mënyrat e matjes së tyre.

III. PLANI I TRAJNIMIT

Prezantimi i manualit sipas moduleve të treguara në Tabelën e Përmbajtjes më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje 2 orë, sipas tabelës së mëposhtme:

Aktiviteti	Metoda	Kohëzgjatja
<p>Moduli 1-3</p> <p>Me anë të këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen me aktet ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme që parashikojnë standardet për akses në arkivat gjyqësore, në qendrën e dokumentacionit dhe database elektronike.</p> <p>Gjithashtu në këtë modul do të pasqyrohet roli që kanë rregulloret e gjykatave për marrëdhëniet me publikun.</p> <p>Do të vijojë me identifikimin e faktorëve apo indikatorëve përbërës të secilës temë të trajtuar lidhur me Modulet 1-3. Më pas, për secilin faktor trajtohet se cilat janë standardet e zbatueshme të performancës, si tregohet realizimi përkatësisht dhe cilat janë metodat e matjes.</p> <p>Gjithashtu në këtë modul do të prezantohet një udhëzim i shkurtër në lidhje me përdorimin e faqeve zyrtare të gjykatave dhe vendimeve që aksesohen në faqen e gjykatave dhe anonimizimi i vendimeve, të dhënave zyrtare të publikuara nga gjykata, të dhëna që pjesëmarrësit mund t'i përdorin gjatë punës/veprimtarisë së tyre.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/ rasteve studimore</p>	<p>30 minuta</p>

<p>Moduli 6</p> <p>Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me standardet për akses në vendimet dhe procedurat në Gjykatën e Lartë.</p> <p>Do të vijojë me identifikimin e faktorëve apo indikatorëve përbërës të secilës temë të trajtuar lidhur me Modulin 5. Më pas, për secilin faktor trajtohet se cilët janë standardet e zbatueshme të performancës, si tregohet realizimi përkatësisht dhe cilat janë metodat e matjes.</p> <p>Gjithashtu në këtë modul do të prezantohet një udhëzim i shkurtër në lidhje me përdorimin e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, të dhënave zyrtare të publikuara, të dhëna që pjesëmarrësit mund t'i përdorin gjatë punës/veprimtarisë së tyre.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p>	<p>30 minuta</p>
--	--------------------------------	------------------

IV. MONITORIMI I DISPONUESHMËRISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE CIVILE

Disponueshmëria në vendimet gjyqësore civile përbën një të drejtë themelore dhe të natyrshme për sa vendimi gjyqësor është edhe vetë përfundimi dhe zgjidhja e rastit/çështjes, dhe njëkohësisht detyrimi final i gjykatës.

Ky detyrim funksional për të dhënë drejtësi është si i tillë i veshur me disa detyrime themelore dhe të shumanshme, si është detyrimi i gjykatës për të vendosur për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e natyrës civile, detyrimi për t'u dhënë vendimi publikisht, që burojnë nga Neni 6 i KEDNj-së, apo detyrimi për të dhënë vendime të arsyetuara, brenda afateve të arsyeshme, të shpallura publikisht etj., sipas nenit 42 dhe nenit 142 të Kushtetutës.

Nga ana tjetër, disponueshmëria në vendimet gjyqësore civile na tregon edhe se sa efçente janë gjykatat në menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe në përmbushjen e afateve në kohë.

IV.1 Faktori 1 - Institucionet përgjegjëse për informimin mbi vendimet gjyqësore

IV.1.1 Standardi i performancës

Gjykatat janë më së pari përgjegjëse për të ndërtuar një sistem disponueshmërie dhe për të garantuar mundësinë e palëve, publikut të interesuar dhe medias në marrjen e vendimeve gjyqësore ose dokumentacionit, në mënyrë të plotë, të saktë dhe në kohë të shpejtë.

Për këtë qëllim janë parashikuar dhe duhet të materializohen plotësisht një sërë mjetesh që tregohen në kuadrin ligjor në fuqi, e që aktualisht posedohen nga gjykatat në funksion të ndërtimit të një marrëdhënieje të hapur, transparente, të besueshme dhe të përgjegjshme me publikun dhe median.

Ndryshimet e parashikuara në paketën e ligjeve të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi parashikojnë se gjykatat duhet të krijojnë dhe përditësojnë arkivat elektronike ku duhet të mbajnë dokumentacionin elektronik. Madje, sipas vendimmarrjes së qeverisë¹ për krijimin dhe organizimin e një qendre informacioni elektronik për sistemin gjyqësor, i gjithë sistemi do të bazohet në një faqe zyrtare online dhe ky sistem do të jetë i centralizuar dhe efektiv për të gjitha gjykatat në Shqipëri. Fillimisht sistemi do të funksionojë dhe ofrojë si një platformë zgjidhje me një ndalesë (*one stop shop*) për të aksesuar pikërisht vendimet gjyqësore.

Pranë çdo gjykate organizohet administrata gjyqësore në përputhje me nenin 41 të ligjit nr. 98/2016. Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve vijuese:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave me nr. 972, datë 02.10.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin Gjyqësor".

shërbime administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore.

Shërbimet për marrëdhëniet me publikun: kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që t'i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore apo t'i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik.

Gjithashtu ky shërbim është përgjegjës që të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit", në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore si edhe që të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.

Shërbimi i arkivit gjyqësor: mban dhe administron dokumentacionin gjyqësor, i cili përfshin dosje, regjistra dhe akte të tjera gjyqësore, si dhe akte që lidhen me veprimtarinë administrative të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërorë.

Me miratimin e rregullave të reja standarde² për organigramën dhe detyrat e përgjegjësitë e nëpunësve gjyqësorë dhe punonjësve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat kanë detajuar dhe përcaktuar strukturat përgjegjëse, emri i shërbimit në strukturën organizative është: Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë. Nëpunësi civil gjyqësor, specialist i marrëdhënieve me publikun, median dhe me jashtë, në veçanti siguron, në bashkërendim me kancelarin, publikimin e të gjitha vendimeve gjyqësore në përputhje me ligjin dhe kujdeset që publikut t'i sigurohet, sipas formës/mënyrës së miratuar nga Këshilli i Gjykatës, informacion faktik rreth statusit të gjykimit të çështjes dhe vendimeve gjyqësore.

Këto përgjegjësi janë të ndërthurura me ato të kancelarit të Gjykatës, përderisa është kancelari i cili kujdeset për publikimin e vendimeve gjyqësore të trupave gjykues të gjykatës dhe siguron që të gjitha proceset që lidhen me menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe publikimin e vendimeve të gjykatës të realizohen në përputhje me standardet më të larta profesionale.

Duhet mbajtur parasysh se shërbimet për marrëdhëniet me publikun, median dhe me jashtë kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit dhe zbatimin e të drejtës së informimit mbi veprimtarinë e gjykatës në funksion të transparencës që gjykata duhet të tregojë në lidhje me çdo shërbim apo aktivitet që kryen, duke garantuar në të njëjtën kohë edhe të drejtën për ruajtjen e të dhënave personale.

Në zbatim të sa më sipër, sipas rregulloreve të gjykatave për marrëdhëniet me publikun, mund të përmbledhim se autoritetet përgjegjëse janë: Kryetari i Gjykatës; Kancelari; Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë; Sekretaria gjyqësore / Zyra e Vendimeve; Shërbimi i Arkivit.

2. Vendimi nr. 148, datë 29.03.2023 i KLGj-së.

Qendra e Dokumentacionit pranë Gjykatës së Lartë, siguron transparencën dhe aksesin online të vendimeve të kësaj gjykate³. Të gjitha dokumentet zyrtare duhet të jenë të regjistruara dhe të publikuara, ndërkohë që duhet të jetë i inkurajuar publikimi në databasen elektronike.

Këto struktura duhet të sigurojnë që disponueshmëria në vendimet gjyqësore të jetë efektive dhe sipas mjeteve më të pranueshme për kërkuesin.

Njëkohësisht, këto struktura duhet të përditësojnë databazën elektronike (përfshirë edhe vendimet e ndërmjetme me arsyetim të shkurtuar për shtyrjen e gjykimeve dhe arsyen e shtyrjes, si dhe të gjitha vendimet përfundimtare, të marra nga gjykata, duke saktësuar nëse vendimi ka marrë apo jo formë të prerë).

IV.1.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit tek institucionet përgjegjëse për informimin mbi vendimet gjyqësore duhet të vërehen në ekzistencën e këtyre elementeve:

- Nëpunës gjyqësor përgjegjës për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun për të siguruar disponueshmërinë e vendimeve gjyqësore (të cilat gjenden ose jo online) dhe për të dhënë përgjigje për informacionet të cilat lidhen me disponueshmërinë e vendimeve gjyqësore të aksesueshme ose jo nga publiku i gjerë, si edhe vlerësimin e arsyeve për rastet kur duhet të realizohet mbrojtja e të dhënave që nuk mund të bëhen publike.
- Faqe interneti e lehtë për t'u orientuar dhe me informacion faktik mbi strukturat përgjegjëse dhe nëpunësit përgjegjës për të dhënë vendimet gjyqësore ose që të ketë të disponueshëm një funksion të mirë kërkimi për të gjetur vendimet gjyqësore.
- Përmbledhje e rregullave të gjykatës në një dokument të vetëm të thjeshtë dhe të disponueshëm, ku përfshihet informacion se ku, kur dhe si mund të merret vendimi gjyqësor pranë institucioneve përgjegjëse.

IV.1.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht me anë të konstatimit me PO/JO.

Duke u bazuar në të dhënat që mund të merren në faqen e gjykatës ose edhe në ambientet e gjykatës, mund të analizohet nëse jepen të dhënat mbi institucionet përgjegjëse për disponueshmërinë e vendimeve dhe fakti nëse informacioni është i plotë dhe i përditësuar sipas ndryshimeve ligjore dhe sipas standardeve. Krahas kësaj, mund të merret informacion mbi mënyrën e cila është në zbatim nga institucionet përgjegjëse në gjykatë për t'iu drejtuar dhe për të paraqitur kërkesa për marrje vendimesh gjyqësore. Për shembull, a ka një formular aplikimi specifik ose të përgjithshëm për këtë qëllim?

3. Neni 35 i ligjit nr. 98/2016, sipas të cilit: Qendra e dokumentacionit bën: a) sigurimin e publikimit të menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale; b) analizën dhe vlerësimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe siguron publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë; c) ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe u jep gjyqtarëve, ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave. 2. Qendra e dokumentacionit punon nën mbikëqyrjen e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

Të dhënat: periudha e monitorimit, të dhëna nga struktura dhe organigrama e publikuar në faqen e gjykatës, të dhëna zyrtare nga raportet periodike të publikuara nga gjykata ose raportet 3-mujore⁴ të dërguara nga Kryetarët e Gjykatave në KLGj.

Burimi i të dhënave: Gjykata, KLGj

IV.2 Faktori 2 - Shpallja dhe publikimi i vendimeve gjyqësore

IV.2.1 Standardi i performancës

Vendimet e gjykatave jepen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe duhet të jenë publike dhe të aksesueshme për publikun.

E drejta për të aksesuar vendimet gjyqësore theksohet edhe nga ligji nr. 119/2014, i cili publikimin dhe marrjen e një vendimi e përfshin në kategorinë e informacionit që autoriteti publik duhet të vendosë në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Sipas Rregullores për Marrëdhëniet e Gjykatës me Publikun, vendimet gjyqësore të gjykatave të çdo niveli bëjnë pjesë në kategorinë e informacionit që mund të merret pa kufizim dhe si rrjedhojë janë lehtësisht të përdorshme nga publiku. Rregullorja përcakton se vendimet e dhëna nga gjykatat, pavarësisht nëse kanë marrë apo jo formë të prerë, duhet të publikohen në faqen e internetit të çdo gjykate.

Me krijimin e faqeve zyrtare të web-it, vendimet e gjykatave mund të aksesohen në faqet web të gjykatave, por këto vendime rezultojnë të jenë të anonimizuar. Anonimizimi i vendimeve, vjen për shkak të Udhëzimit nr. 15 KMDHP i cili bazohet në Ligjin nr. 9887/2008.

Pavarësisht se ky udhëzim ka si qëllim mbrojtjen e të dhënave me karakter personal dhe ruajtjen e privatësisë së individit, vihet re se vendimet gjyqësore shpesh janë plotësisht të anonimizuara, duke cenuar edhe të drejtën e qytetarëve për t'u informuar dhe për t'i aksesuar këto vendime në mënyrë elektronike.

IV.2.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të shpalljes dhe publikimit të vendimeve gjyqësore orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A ndodh publikimi online i vendimeve gjyqësore, kryesisht nga gjykata, në respektim të kërkesave për anonimizimin e tyre?
- A trajtohen qytetarët në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese nga gjykatat?
- A ka në zbatim në gjykatë një sistem funksional të teknologjisë së informacionit, i cili mundëson publikimin e të dhënave/vendimeve duke i përfshirë ato në procesin automatik të anonimizimit?

4. Sipas Vendimit të KLGj-së, me nr. 25, datë 07.02.2019, "Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore"

IV.2.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht në përqindje. Duke u bazuar në të dhënat që mund të merren në faqen e gjykatës ose edhe në ambientet e gjykatës, mund të merret numri i vendimeve të publikuara apo të disponueshme për publikun dhe numri i vendimeve të dhëna nga gjykata për çështjet gjyqësore që janë përfunduar dhe për të cilat është marrë një vendim nga ana e gjykatës, përgjatë periudhës së monitorimit. Duhet të mbahet parasysh se periudha e monitorimit mund të jetë relativisht e gjatë për shkak të kohës së nevojshme të përcaktuar si afat nga ligji për përfundimin e një çështjeje civile, deri në 2 vjet.

Vlera në % = numri i çështjeve për të cilat vendimet janë të publikuara online / totali i numrit të çështjeve të përfunduara me vendim nga ana e gjykatës x 100

Sa më e lartë të rezultojë vlera si më sipër, aq më mirë përmbushet detyrimi i shpalljes dhe i publikimit të vendimeve.

Të dhënat: periudha e monitorimit, numri dhe lloji i vendimeve të gjykatës, statistika ose të dhëna zyrtare nga raportet periodike të publikuara nga gjykata.

Burimi i të dhënave: Gjykata, KLGj-ja.

IV.3 Faktori 3 – Korrigjimi i gabimeve në vendim dhe interpretimi i tij

IV.3.1 Standardi i performancës

Nevoja për plotësim apo korrigjim në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në vendimin e gjykatës përbën edhe një nga treguesit e shkallës së aftësisë së gjyqtarit.

Gjykatat, në çdo kohë, duhet të ndreqin çdo gabim të bërë në shkrim, në llogari ose në lidhje me ndonjë pasaktësi të dukshme në vendim. Po kështu, gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët.

Është detyrë e nëpunësit civil gjyqësor, specialist i marrëdhënieve me publikun, mediat dhe me jashtë, të kujdeset që publikut t'i sigurohet sipas formës/mënyrës së miratuar nga Këshilli i Gjykatës, informacion faktik rreth statusit të gjykimit të çështjes, vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara.

IV.3.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të korrigjimit të gabimeve në Vendim dhe sqarimin e tij, orientohen nga përgjigjet e këtyre pyetjeve:

- A ka informacion të publikuar dhe lehtësisht të aksesueshëm nga publiku në lidhje me të drejtën e palëve për të kërkuar dhe kryer korrigjimin e gabimeve në vendimin e gjykatës ose për të kërkuar sqarimin e tij?
- A publikohen vendimet e gjykatës në përgjigje apo zgjidhje të kërkesave të palëve për korrigjimin/sqarimin e vendimit gjyqësor?

IV.3.3 Metoda e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion: në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja *online* e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë, i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

Të dhënat: periudha e monitorimit, numri dhe lloji i kërkesave të palëve për korrigjim/sqarim vendimi gjyqësor të cilat janë pranuar nga gjykata, statistika.

Burimi i të dhënave: Gjykata, KLGj

IV.4 Faktori 4 – Koha për disponueshmërinë e vendimeve

IV.4.1 Standardi i performancës

Kohëzgjatja e arsytimit të vendimit nënkupton kohën nga momenti i shpalljes së dispozitivit në seancë e deri kur vendimi dorëzohet bashkë me dosjen gjyqësore në sekretarinë e gjykatës.

Koha për disponueshmërinë e vendimeve është e lidhur drejtpërdrejt me procesin e rregullt ligjor dhe detyrimet që imponon neni 6 i KEDNj-së. Në dallim nga ecuria dhe koha e procesit gjyqësor ku pavarësisht se rolin kryesor e luan gjyqtari, palët kanë të drejtë të shprehen dhe të ndikojnë edhe përmes avokatëve të tyre në këta hapa proceduralë, në arsyetimin, zbardhjen dhe dorëzimin e vendimit gjyqësor në dosje dhe sistem elektronik të disponueshëm për palët, roli i përket tërësisht dhe vetëm gjyqtarit. Këtu përgjegjësia për vonesa është vetëm e gjyqtarëve. Gjyqtarët kanë detyrimin ligjor për të përmbushur prioritetin e respektimit të të drejtave të mbrojtura nga neni 6 i KEDNj-së dhe legjislacioni vendas lidhur me gjykimin e shpejtë dhe mundësimin e pajisjes së qytetarit me një vendim.

Në vijim, dorëzimi i vendimit në kohën e caktuar është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, sepse kështu mundësohet edhe e drejta e palës për të ushtruar të drejtën e ankimit nga një gjykatë më e lartë.

Ky problem gjen trajtim edhe më të hollësishëm në jurisprudencën e GjEDNj-së, ku, për të vlerësuar kohën, duhet të merret parasysh e gjithë periudha nga momenti i depozitimit të kërkesëpadsisë deri sa vendimi merr formë të prerë (depozitohet në sekretari). Sikurse e themi më sipër, një zgjatje e tepruar nga seanca e fundit deri në nxjerrjen e një vendimi të arsyetuar mund të cenojë të drejtën e gjykimit pa vonesa të panevojshme dhe të pengojë mundësinë e palëve për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e ankimit.

K.Pr.C e detyron gjykatën të dorëzojë vendimin të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë. Por njëkohësisht gjykata është e detyruar të shpallë dhe të regjistrojë në sistemin elektronik dispozitivin e vendimit brenda ditës.

IV.4.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të kohës për disponueshmërinë e vendimeve mund të merren nga përgjigjet e këtyre pyetjeve:

- Sa është numri i vendimeve gjyqësore ose përqindja e tyre, të dorëzuara në sekretarinë e gjykatës brenda afatit ligjor?
- A shënohet në sekretarinë gjyqësore një Regjistër i posaçëm i Vendimeve Civile dhe a shënohen në këtë regjistër (krahas të dhënave të tjera) data e dhënies së vendimit dhe data e dorëzimit të këtij vendimi në sekretari?

IV.4.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht në përqindje. Për matjen e tij duhet që, bazuar në të dhënat e disponueshme në Regjistrin e Vendimeve Civile, të llogaritet në përqindje numri i rasteve kur vendimi gjyqësor është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit ligjor, përgjatë periudhës së monitorimit, në raport me numrin total të vendimeve gjyqësore që janë marrë nga gjykata:

Vlera në % = Numri i vendimeve gjyqësore të dorëzuara brenda afatit ligjor / numri i përgjithshëm i vendimeve gjyqësore gjatë periudhës raportuese x 100

Të dhënat:

- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore për të cilat gjykata ka marrë vendim të arsyetuar dhe e ka publikuar këtë vendim online (ose jo) për periudhën e monitorimit;
- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore për të cilat është marrë vendim, për periudhën e monitorimit;

Burimi i të dhënave: Si burim për këtë indikator shërbejnë të dhënat që merren nga Regjistri i Vendimeve Civile që mban sekretaria gjyqësore, si edhe nga verifikimi i faqes zyrtare online të gjykatave.

IV.5 Faktori 5 - Lehtësia e kërkimit në bazat e të dhënave përkatëse nga publiku i gjerë

IV.5.1 Standardi i performancës

Aksesi në çështjet gjyqësore, kërkon fillimisht që publiku të ketë informacion të plotë, të saktë dhe të përditësuar për çështjet që janë duke u gjykuar nga gjykata. Gjithashtu, qytetari duhet të marrë në kohë dhe të aksesojë vendimet e gjykatës. Për këtë, është e nevojshme që çdo gjykatë të ketë të digjitalizuar dhe funksionale arkivën elektronike gjyqësore⁵. Gjithashtu, për shkak të rolit të Vendimeve të Gjykatës së Lartë në njësimin e praktikës gjyqësore, Qendra e Dokumentacionit pranë kësaj gjykate duhet të sigurojë transparencën dhe aksesin *online* të vendimeve të kësaj gjykate⁶.

5. Shih nenin 48 të Ligjit nr.96/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

6. Shih nenin 35 të ligjit nr.98/2016.

Po kështu, gjykatat duhet të garantojnë që çdo person të ketë akses të barabartë në gjykatë, si për sa i përket informacionit dhe dokumentacionit që ajo administron, ashtu dhe sa i takon mbrojtjes të të drejtave të tyre ligjore dhe trajtimit të tij pa asnjë diskriminim në proceset gjyqësore.

IV.5.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit, te lehtësia e kërkimit në bazat e të dhënave përkatëse nga publiku i gjerë orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A publikojnë gjykatat në faqen e vet në internet të dhëna për çështjet gjyqësore të gjykuara, si dhe ato në proces?
- A është informacioni i publikuar në faqen elektronike të gjykatës për çështjet gjyqësore në proces i përditësuar, sipas fazës së gjykimit?
- A mund të aksesojë publiku, dokumentet e një dosjeje gjyqësore, në përputhje me parashikimet e ligjit?
- A janë të digjitalizuara arkivat gjyqësore?
- A ka programe që i shërbejnë publikut të gjerë, për të kuptuar rolin e gjykatës dhe vendosjen e marrëdhënieve me gjykatën?
- A trajtohen qytetarët në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese nga gjykatat?

IV.5.3 Metodat e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion: në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë, i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

IV. 6 Faktori 6 - Përmbledhje e ecurisë së rasteve dhe / ose kronologjia e rasteve

IV.6.1 Standardi i performancës

Sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efijencës, në përputhje me nenin 2 të Ligjit nr. 115/2016.

Palët në proces janë sigurisht më të interesuarat dhe duhet të kenë informacion online, në mënyrë që të jenë në dijeni për statusin e çështjes së tyre dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga ana e gjykatës. Nga ana tjetër, edhe publiku duhet të ketë informacion për çështjet gjyqësore që shqyrtohen nga gjykata, objektin e tyre, statusin, kohëzgjatjen, ecurinë e çështjes, dispozitivin e vendimeve.

Kështu matet dhe monitorohet veprimtaria e gjykatës, si nga palët pjesëmarrëse në proces,

ashtu edhe nga publiku i gjerë. Është e rëndësishme që informacioni bazë jo vetëm të jetë online, për të gjitha çështjet në shqyrtim, por edhe i përditësuar.

Kështu matet indirekt edhe respektimi i parimit të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, i cili ka një rëndësi themelore për gjykimin civil, pasi përbën dhe një nga elementet e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ky parim bazohet në postulatin “drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”. Periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë deri te momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor⁷. Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

Rregullorja e gjykatës për marrëdhëniet me publikun ka përcaktuar se:

Çdo faqe interneti e gjykatës duhet të përmbajë detyrimisht këto elemente:

- Informacion mbi kalendarin e gjykimeve për çdo çështje të regjistruar në regjistrat e gjykatës. Ky përfshin edhe vendimet e ndërmjetme me arsyetim të shkurtuar për shtyrjen e gjykimeve dhe arsyen e shtyrjes;
- Informacion mbi apelin e ushtruar;
- Të gjitha vendimet përfundimtare, të marra nga gjykata, duke saktësuar nëse ka marrë apo jo formë të prerë;
- Informacion të karakterit orientues dhe edukues për palët dhe për publikun e gjerë;
- Njoftimet për shtyp të bëra nga gjykata.

Për çdo seancë gjyqësore ose pas çdo procesi gjyqësor, trupi gjykues ose gjyqtari i vetëm i çështjes ka të drejtë të vendosë për të informuar publikun në mënyrë të përmbledhur mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet një deklarate për shtyp. Gjyqtari ose trupi gjykues nuk mund të detyrohen ta bëjnë një gjë të tillë. Kjo realizohet përmes një deklarate nga ana e ZMP, me një tekst të thjeshtë për publikun, i cili tregon edhe ecurinë e çështjes.

IV.6.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit, te përmbledhja e ecurisë së rasteve / kronologjia e rasteve orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A publikojnë gjykatat në faqen e vet në internet të dhënat e ecurisë ose kronologjinë për çështjet gjyqësore në proces?
- A është informacioni i publikuar në faqen elektronike të gjykatës për çështjet

7. Shih vendimin “Qufaj kundër Shqipërisë”; Vendimin “Scopelliti kundër Italisë”, datë 23.11.1993 të GJEDNJ-së.

gjqësore në proces i përditësuar, sipas fazës së gjykimit?

- A ka të publikuara në faqen e gjykatës deklarata për shtyp të cilat tregojnë përmbledhje të çështjeve gjyqësore dhe ecurinë e tyre?

IV.6.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht në përqindje. Për matjen e tij duhet që, bazuar në të dhënat e disponueshme në faqen e gjykatës, të llogaritet në përqindje numri i rasteve kur informacioni bazë në lidhje me ecurinë e rasteve është i disponueshëm në internet dhe i përditësuar, përgjatë periudhës së monitorimit, në raport me numrin e çështjeve gjyqësore që janë duke u shqyrtuar nga gjykata:

Vlera në % = Numri i çështjeve gjyqësore në vazhdim me informacionin themelor të azhornuar sipas kronologjisë së rastit të disponueshëm publikisht / numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces gjatë periudhës raportuese x 100

Për matjen e këtij indikator ka rëndësi të vlerësohet nëse informacioni për çështjet jepet në të gjithë komponentët kryesorë, si edhe nëse është i përditësuar në kohë.

Të dhënat:

- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces me informacion themelor të azhornuar sipas kronologjisë të disponueshme publikisht online për periudhën e monitorimit;

- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces me informacion themelor të azhornuar sipas kronologjisë të disponueshme publikisht online dhe të përditësuar, për periudhën e monitorimit;

Burimi i të dhënave: Si burim për këtë indikator shërbejnë të dhënat që merren nga verifikimi i faqes zyrtare online të gjykatave, si edhe të dhënat e marra nga publikimet e KLGj-së.

V. MONITORIMI I DISPONUESHMËRISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE

Disponueshmëria në vendimet gjyqësore penale përbën një të drejtë themelore dhe të natyrshme për sa vendimi gjyqësor është edhe vetë përfundimi dhe zgjidhja e rastit/çështjes, dhe njëkohësisht detyrimi final i gjykatës. Ky detyrim funksional për të dhënë drejtësi është si i tillë i veshur me disa detyrime themelore dhe të shumanshme, si është detyrimi i gjykatës për të vendosur për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të personit, detyrimi për t'u dhënë vendimi publikisht, që burojnë nga Neni 6 i KEDNj-së, apo detyrimi për të dhënë vendime të arsyetuara, brenda afateve të arsyeshme, të shpallura publikisht etj., sipas nenit 42 dhe nenit 142 të Kushtetutës.

V.1 Faktori 1 - Institucionet përgjegjëse për informimin mbi vendimet gjyqësore

V.1.1 Standardi i performancës

Gjykatat janë më së pari përgjegjëse për të ndërtuar një sistem disponueshmërie dhe garantuar mundësinë e palëve, publikut të interesuar dhe medias në marrjen e vendimeve gjyqësore ose dokumentacionit, në mënyrë të plotë, të saktë dhe në kohë të shpejtë.

Për këtë qëllim janë parashikuar dhe duhet të materializohen plotësisht një sërë mjetesh që tregohen në kuadrin ligjor në fuqi, e që aktualisht posedohen nga gjykatat në funksion të ndërtimit të një marrëdhënieje të hapur, transparente, të besueshme dhe të përgjegjshme me publikun dhe median.

Ndryshimet e parashikuara në paketën e ligjeve të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi parashikojnë se gjykatat duhet të krijojnë dhe përditësojnë arkivat elektronike ku duhet të mbajnë dokumentacionin elektronik. Madje, sipas vendimmarrjes së qeverisë⁸ për krijimin dhe organizimin e një qendre informacioni elektronik për sistemin gjyqësor, i gjithë sistemi do të bazohet në një faqe zyrtare online dhe ky sistem do të jete i centralizuar dhe efektiv për të gjitha gjykatat në Shqipëri. Fillimisht sistemi do të funksionojë dhe ofrojë si një platformë zgjidhje me një ndalesë (one stop shop) për të aksesuar pikërisht vendimet gjyqësore.

Pranë çdo gjykate organizohet administrata gjyqësore në përputhje me nenin 41 të ligjit nr. 98/2016. Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve vijuese:

8. Vendim i Këshillit të Ministrave me nr. 972, datë 02.10.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin Gjyqësor".

shërbime administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore.

Shërbimet për marrëdhëniet me publikun: kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që t'i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore apo t'i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik.

Gjithashtu ky shërbim është përgjegjës që të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit", në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore, si edhe që të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.

Shërbimi i arkivit gjyqësor: mban dhe administron dokumentacionin gjyqësor, i cili përfshin dosje, regjistra dhe akte të tjera gjyqësore, si dhe akte që lidhen me veprimtarinë administrative të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërorë.

Me miratimin e rregullave të reja standarde⁹ për organigramën dhe detyrat e përgjegjësitë e nëpunësve gjyqësorë dhe punonjësve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat kanë detajuar dhe përcaktuar strukturat përgjegjëse, emri i shërbimit në strukturën organizative është: Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë. Nëpunësi civil gjyqësor specialist i marrëdhënieve me publikun, median dhe me jashtë, në veçanti siguron në bashkërendim me kancelarin publikimin e të gjitha vendimeve gjyqësore, në përputhje me ligjin dhe kujdeset që publikut t'i sigurohet sipas formës/mënyrës së miratuar nga Këshilli i Gjykatës, informacion faktik rreth statusit të gjykimit të çështjes dhe vendimeve gjyqësore.

Këto përgjegjësi janë të ndërthurura me ato të kancelarit të Gjykatës, përderisa është kancelari i cili kujdeset për publikimin e vendimeve gjyqësore të trupave gjykues të gjykatës dhe siguron që të gjitha proceset që lidhen me menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe publikimin e vendimeve të gjykatës të realizohen në përputhje me standardet më të larta profesionale.

Duhet mbajtur parasysh se shërbimet për marrëdhëniet me publikun, median dhe me jashtë kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit dhe zbatimin e të drejtës së informimit mbi veprimtarinë e gjykatës në funksion të transparencës që gjykata duhet të tregojë në lidhje me çdo shërbim apo aktivitet që kryen, duke garantuar në të njëjtën kohë edhe të drejtën për ruajtjen e të dhënave personale.

Në zbatim të sa më sipër, sipas rregulloreve të gjykatave për marrëdhëniet me publikun, mund të përmbledhim se autoritetet përgjegjëse janë: Kryetari i Gjykatës; Kancelari; Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me

9. Vendimi nr. 148, datë 29.03.2023 i KLGj-së.

Jashtë; Sekretaria gjyqësore / Zyra e Vendimeve; Shërbimi i Arkivit.

Qendra e Dokumentacionit pranë Gjykatës së Lartë, siguron transparencën dhe aksesin online të vendimeve të kësaj gjykate¹⁰. Të gjitha dokumentet zyrtare duhet të jenë të regjistruara dhe të publikuara, ndërkohë që duhet të jetë i inkurajuar publikimi në databazën elektronike.

Këto struktura duhet të sigurojnë që disponueshmëria në vendimet gjyqësore të jetë efektive dhe sipas mjeteve më të pranueshme për kërkuesin.

Njëkohësisht, këto struktura, duhet të përditësojnë databazën elektronike (përfshirë edhe vendimet e ndërmjetme me arsyetim të shkurtuar për shtyrjen e gjykimeve dhe arsyen e shtyrjes, si dhe të gjitha vendimet përfundimtare, të marra nga gjykata, duke saktësuar nëse vendimi ka marrë apo jo formë të prerë).

V.1.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit tek institucionet përgjegjëse për informimin mbi vendimet gjyqësore duhet të vërehen në ekzistencën e këtyre elementeve:

- Nëpunës gjyqësor përgjegjës për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun për të siguruar disponueshmërinë e vendimeve gjyqësore (të cilat gjenden ose jo online) dhe për të dhënë përgjigje për informacionet të cilat lidhen me disponueshmërinë e vendimeve gjyqësore të aksesueshme ose jo nga publiku i gjerë, si edhe vlerësimin e arsyeve për rastet kur duhet të realizohet mbrojtja e të dhënave që nuk mund të bëhen publike.
- Faqe interneti e lehtë për t'u orientuar dhe me informacion faktik mbi strukturat përgjegjëse dhe nëpunësit përgjegjës për të dhënë vendimet gjyqësore ose që të ketë të disponueshëm një funksion të mirë kërkimi për të gjetur vendimet gjyqësore.
- Përmbledhje e rregullave të gjykatës në një dokument të vetëm të thjeshtë dhe të disponueshëm ku përfshihet informacion se ku, kur dhe si mund të merret vendimi gjyqësor pranë institucioneve përgjegjëse.

V.1.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht me anë të konstatimit me PO/JO. Duke u bazuar në të dhënat që mund të merren në faqen e gjykatës ose edhe në ambientet e gjykatës, mund të analizohet nëse jepen të dhënat mbi institucionet përgjegjëse për disponueshmërinë e vendimeve dhe fakti nëse informacioni është i plotë dhe i përditësuar sipas ndryshimeve ligjore dhe sipas standardeve. Krahas kësaj, mund të merret informacion mbi mënyrën e cila është në zbatim nga institucionet përgjegjëse në gjykatë për t'u drejtuar dhe për të paraqitur kërkesa për marrje vendimesh gjyqësore. Për shembull, a ka një formular

10. Neni 35 i ligjit nr.98/2016, sipas të cilit: Qendra e dokumentacionit bën: a) sigurimin e publikimit të menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale; b) analizën dhe vlerësimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe siguron publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë; c) ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe u jep gjyqtarëve, ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave.2. Qendra e dokumentacionit punon nën mbikëqyrjen e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

aplikimi specifik ose të përgjithshëm për këtë qëllim?

Të dhënat: periudha e monitorimit, të dhëna nga struktura dhe organigrama e publikuar në faqen e gjykatës, të dhëna zyrtare nga raportet periodike të publikuara nga gjykata ose raportet 3-mujore¹¹ të dërguara nga Kryetarët e Gjykatave në KLGj.

Burimi i të dhënave: Gjykata, KLGj-ja.

V.2 Faktori 2 - Shpallja dhe publikimi i vendimeve gjyqësore

V.2.1 Standardi i performancës

Vendimet e gjykatave jepen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe duhet të jenë publike dhe të aksesueshme për publikun.

E drejta për të aksesuar vendimet gjyqësore theksohet edhe nga ligji nr. 119/2014, i cili publikimin dhe marrjen e një vendimi e përfshin në kategorinë e informacionit që autoriteti publik duhet të vendosë në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Sipas Rregullores për Marrëdhëniet e Gjykatës me Publikun, vendimet gjyqësore të gjykatave të çdo niveli bëjnë pjesë në kategorinë e informacionit që mund të merret pa kufizim dhe si rrjedhojë janë lehtësisht të përdorshme nga publiku. Rregullorja përcakton se vendimet e dhëna nga gjykatat, pavarësisht nëse kanë marrë apo jo formë të prerë, duhet të publikohen në faqen e internetit të çdo gjykate.

Me krijimin e faqeve zyrtare të web-it, vendimet e gjykatave mund të aksesohen në faqet web të gjykatave, por këto vendime rezultojnë të jenë të anonimizuar. Anonimizimi i vendimeve, vjen për shkak të Udhëzimit nr. 15 KMDHP, i cili bazohet në Ligjin nr. 9887/2008.

Pavarësisht se ky udhëzim ka si qëllim mbrojtjen e të dhënave me karakter personal dhe ruajtjen e privatësisë së individit, vihet re se vendimet gjyqësore shpesh janë plotësisht të anonimizuara, duke cenuar edhe të drejtën e qytetarëve për t'u informuar dhe për t'i aksesuar këto vendime në mënyrë elektronike.

V.2.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit, të shpalljes dhe publikimit të vendimeve gjyqësore orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A ndodh publikimi online i vendimeve gjyqësore, kryesisht nga gjykata, në respektim të kërkesave për anonimizimin e tyre?
- A trajtohen qytetarët në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese nga gjykatat?
- A ka në zbatim në gjykatë një sistem funksional të teknologjisë së informacionit, i cili mundëson publikimin e të dhënave/vendimeve duke i përfshirë ato në procesin automatik të anonimizimit?

11. Sipas Vendimit të KLGj-së, nr. 25, datë 07.02.2019 "Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore".

V.2.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht në përqindje. Duke u bazuar në të dhënat që mund të merren në faqen e gjykatës ose edhe në ambientet e gjykatës, mund të merret numri i vendimeve të publikuara apo të disponueshme për publikun dhe numri i vendimeve të dhëna nga gjykata për çështjet gjyqësore që janë përfunduar dhe për të cilat është marrë një vendim nga ana e gjykatës, përgjatë periudhës së monitorimit. Duhet të mbahet parasysh se periudha e monitorimit mund të jetë relativisht e gjatë për shkak të kohës së nevojshme të përcaktuar si afat nga ligji për përfundimin e një çështjeje penale, deri në 2 vjet.

Vlera në % = numri i çështjeve për të cilat vendimet janë të publikuara online / totali i numrit të çështjeve të përfunduara me vendim nga ana e gjykatës x 100

Sa më e lartë të rezultojë vlera si më sipër, aq më mirë përmbushet detyrimi i shpalljes dhe publikimit të vendimeve.

Të dhënat: periudha e monitorimit, numri dhe lloji i vendimeve të gjykatës, statistika ose të dhëna zyrtare nga raportet periodike të publikuara nga gjykata.

Burimi i të dhënave: Gjykata, KLGj-ja.

V.3 Faktori 3 – Korrigjimi i gabimeve në vendim dhe interpretimi i tij

V.3.1 Standardi i performancës

Nevoja për plotësim apo korrigjim në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në vendimin e gjykatës përbën dhe një nga treguesit e shkallës së aftësisë së gjyqtarit.

Gjykata, edhe kryesisht, procedon për ndreqjen e vendimit kur duhet korrigjuar ndonjë gabim material. Por edhe secila nga palët, mund të kërkojë plotësimin e vendimit, në rast se gjykata nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për disponimin e provave.

Është detyrë e nëpunësit civil gjyqësor, specialist i marrëdhënieve me publikun, mediat dhe me jashtë, të kujdeset që publikut t'i sigurohet sipas formës/mënyrës së miratuar nga Këshilli i Gjykatës, informacion faktik rreth statusit të gjykimit të çështjes, vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara.

V.3.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të korrigjimit të gabimeve në vendim dhe sqarimin e tij, orientohen nga përgjigjet e këtyre pyetjeve:

- A ka informacion të publikuar dhe lehtësisht të aksesueshëm nga publiku në lidhje me të drejtën e palëve për të kërkuar dhe kryer korrigjimin e gabimeve në vendimin e gjykatës ose për të kërkuar sqarimin e tij?
- A publikohen vendimet e gjykatës në përgjigje apo zgjidhje të kërkesave të palëve për korrigjimin/sqarimin e vendimit gjyqësor?

V.3.3 Metoda e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion: në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë, i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

Të dhënat: periudha e monitorimit, numri dhe lloji i kërkesave të palëve për korrigjim/sqarim vendimi gjyqësor të cilat janë pranuar nga gjykata, statistika.

Burimi i të dhënave: Gjykata, KLGj-ja.

V.4 Faktori 4 - Koha për disponueshmërinë e vendimeve

V.4.1 Standardi i performancës

Kohëzgjatja e arsytimit të vendimit nënkupton kohën nga momenti i shpalljes së dispozitivit në seancë e deri kur vendimi dorëzohet bashkë me dosjen gjyqësore në sekretarinë e gjykatës

Koha për disponueshmërinë e vendimeve është e lidhur drejtpërdrejt me procesin e rregullt ligjor dhe detyrimet që imponon neni 6 i KEDNj-së. Në dallim nga ecuria dhe koha e procesit gjyqësor, ku pavarësisht se rolin kryesor e luan gjyqtari, palët kanë të drejtë të shprehen dhe të ndikojnë edhe përmes avokatëve të tyre në këta hapa proceduralë, në arsyetimin, zbardhjen dhe dorëzimin e vendimit gjyqësor në dosje dhe sistem elektronik të disponueshëm për palët, roli i përket tërësisht dhe vetëm gjyqtarit. Këtu përgjegjësia për vonesa është vetëm e gjyqtarëve. Gjyqtarët kanë detyrimin ligjor për të përmbushur prioritetin e respektimit të të drejtave të mbrojtura nga neni 6 i KEDNj-së dhe legjislacioni vendas lidhur me gjykimin e shpejtë dhe mundësimin e pajisjes së qytetarit me një vendim.

Në vijim, dorëzimi i vendimit në kohën e caktuar është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, sepse kështu mundësohet edhe e drejta e palës për të ushtruar të drejtën e ankimit nga një gjykatë më e lartë.

K.Pr.P e detyron gjykatën të dorëzojë vendimin të arsyetuar në sekretari jo më vonë se 30 ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në 30 ditë të tjera, nëse çështja është gjykuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Por njëkohësisht gjykata është e detyruar të shpallë dhe të regjistrojë në sistemin elektronik dispozitivin e vendimit brenda ditës.

Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përlegjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.

V.4.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të kohës për disponueshmërinë e vendimeve mund të merren nga përgjigjet e këtyre pyetjeve:

- Sa është numri i vendimeve gjyqësore ose përqindja e tyre, të dorëzuara në sekretarinë e gjykatës brenda afatit ligjor?
- A shënohet në sekretarinë gjyqësore një Regjistër i posaçëm i Vendimeve Penale dhe a shënohen në këtë regjistër (krahas të dhënave të tjera) data e dhënies së vendimit dhe data e dorëzimit të këtij vendimi në sekretari?

V.4.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht në përqindje. Për matjen e tij duhet që, bazuar në të dhënat e disponueshme në Regjistrin e Vendimeve Penale, të llogaritet në përqindje numri i rasteve kur vendimi gjyqësor është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit ligjor, përgjatë periudhës së monitorimit, në raport me numrin total të vendimeve gjyqësore që janë marrë nga gjykata:

Vlera në % = Numri i vendimeve gjyqësore të dorëzuara brenda afatit ligjor / numri i përgjithshëm i vendimeve gjyqësore gjatë periudhës raportuese x 100

Të dhënat:

- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore për të cilat gjykata ka marrë vendim të arsyetuar dhe e ka publikuar këtë vendim online (ose jo) për periudhën e monitorimit;
- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore për të cilat është marrë vendim, për periudhën e monitorimit;

Burimi i të dhënave: Si burim për këtë indikator shërbejnë të dhënat që merren nga Regjistri i Vendimeve Penale (përfshirë Regjistrin e Vendimeve penale ushtarake) që mban sekretaria gjyqësore, si edhe nga verifikimi i faqes zyrtare online të gjykatave.

V.5 Faktori 5 - Lehtësia e kërkimit në bazat e të dhënave përkatëse nga publiku i gjerë

V.5.1 Standardi i performancës

Aksesi në çështjet gjyqësore, kërkon fillimisht që publiku të ketë informacion të plotë, të saktë dhe të përditësuar për çështjet që janë duke u gjykuar nga gjykata. Gjithashtu, qytetari duhet të marrë në kohë dhe të aksesojë vendimet e gjykatës. Për këtë, është e nevojshme që çdo gjykatë të ketë të digjitalizuar dhe funksionale arkivën elektronike gjyqësore¹². Gjithashtu, për shkak të rolit të Vendimeve të Gjykatës së Lartë në njësimin e praktikës gjyqësore, Qendra e Dokumentacionit pranë kësaj gjykate duhet të sigurojë transparencën dhe aksesin *online* të vendimeve të kësaj gjykate¹³.

12. Shih nenin 48 të Ligjit nr.96/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

13. Shih nenin 35 të ligjit nr.98/2016.

Po kështu, gjykatat duhet të garantojnë që çdo person të ketë akses të barabartë në gjykatë, si për sa i përket informacionit dhe dokumentacionit që ajo administron, ashtu dhe sa i takon mbrojtjes të të drejtave të tyre ligjore dhe trajtimit të tij pa asnjë diskriminim në proceset gjyqësore.

V.5.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit, te lehtësia e kërkimit në bazat e të dhënave përkatëse nga publiku i gjerë orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A publikojnë gjykatat në faqen e vet në internet të dhëna për çështjet gjyqësore të gjykuara, si dhe ato në proces?
- A është informacioni i publikuar në faqen elektronike të gjykatës për çështjet gjyqësore në proces i përditësuar, sipas fazës së gjykimit?
- A mund të aksesojë publiku, dokumentet e një dosjeje gjyqësore, në përputhje me parashikimet e ligjit?
- A janë të digjitalizuara arkivat gjyqësore?
- A ka programe që i shërbejnë publikut të gjerë, për të kuptuar rolin e gjykatës dhe vendosjen e marrëdhënieve me gjykatën?
- A trajtohen qytetarët në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese nga gjykatat?

V.5.3 Metodat e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion: në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë, i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

V. 6 Faktori 6 – përmbledhje e ecurisë së rasteve dhe / ose kronologjia e rasteve

V.6.1 Standardi i performancës

Sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe eficientës, në përputhje me nenin 2 të Ligjit nr. 115/2016.

Palët në proces janë sigurisht më të interesuarat dhe duhet të kenë informacion online, në mënyrë që të jenë në dijeni për statusin e çështjes së tyre dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga ana e gjykatës. Nga ana tjetër, edhe publiku duhet të ketë informacion për çështjet gjyqësore që shqyrtohen nga gjykata, objektin e tyre, statusin, kohëzgjatjen, ecurinë e çështjes, dispozitivin e vendimeve.

Kështu matet dhe monitorohet veprimtaria e gjykatës, si nga palët pjesëmarrëse në proces, ashtu edhe nga publiku i gjerë. Është e rëndësishme që informacioni bazë jo vetëm të jetë online, për të gjitha çështjet në shqyrtim, por edhe i përditësuar.

Kështu matet indirekt edhe respektimi i parimit të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, i cili ka një rëndësi themelore për gjykimin, pasi përbën dhe një nga elementet e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Rregullorja e gjykatës për marrëdhëniet me publikun ka përcaktuar se:

Çdo faqe interneti e gjykatës duhet të përmbajë detyrimisht këto elemente:

- Informacion mbi kalendarin e gjykimeve për çdo çështje të regjistruar në regjistrat e gjykatës. Ky përfshin edhe vendimet e ndërmjetme me arsyetim të shkurtuar për shtyrjen e gjykimeve dhe arsyen e shtyrjes;
- Informacion mbi apelin e ushtruar;
- Të gjitha vendimet përfundimtare, të marra nga gjykata, duke saktësuar nëse ka marrë apo jo formë të prerë;
- Informacion të karakterit orientues dhe edukues për palët dhe për publikun e gjerë;
- Njoftimet për shtyp të bëra nga gjykata.

Për çdo seancë gjyqësore ose pas çdo procesi gjyqësor, trupi gjykues ose gjyqtari i vetëm i çështjes ka të drejtë të vendosë për të informuar publikun në mënyrë të përmbledhur mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet një deklarate për shtyp. Gjyqtari ose trupi gjykues nuk mund të detyrohen ta bëjnë një gjë të tillë. Kjo realizohet përmes një deklarate nga ana e ZMP, me një tekst të thjeshtë për publikun, i cili tregon edhe ecurinë e çështjes.

V.6.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit, të përmbledhja e ecurisë së rasteve / kronologjia e rasteve orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A publikojnë gjykatat në faqen e vet në internet të dhënat e ecurisë ose kronologjinë për çështjet gjyqësore në proces?
- A është informacioni i publikuar në faqen elektronike të gjykatës për çështjet gjyqësore në proces i përditësuar, sipas fazës së gjykimit?
- A ka të publikuara në faqen e gjykatës deklarata për shtyp të cilat tregojnë përmbledhje të çështjeve gjyqësore dhe ecurinë e tyre?

V.6.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht në përqindje. Për matjen e tij duhet që, bazuar në të dhënat e disponueshme në faqen e gjykatës, të llogaritet në përqindje numri i rasteve kur informacioni bazë në lidhje me ecurinë e rasteve është i disponueshëm në internet dhe i përditësuar, përgjatë periudhës së monitorimit, në raport me numrin e çështjeve gjyqësore që janë duke u shqyrtuar nga gjykata:

Vlera në % = Numri i çështjeve gjyqësore në vazhdim me informacionin themelor të azhurnuar

sipas kronologjisë së rastit të disponueshëm publikisht / numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces gjatë periudhës raportuese x 100

Për matjen e këtij indikatori ka rëndësi të vlerësohet nëse informacioni për çështjet jepet në të gjithë komponentët kryesorë, si edhe nëse është i përditësuar në kohë.

Të dhënat:

- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces me informacion themelor të azhurnuar sipas kronologjisë të disponueshëm publikisht online për periudhën e monitorimit.
- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces me informacion themelor të azhurnuar sipas kronologjisë të disponueshëm publikisht online dhe të përditësuar, për periudhën e monitorimit.

Burimi i të dhënave: Si burim për këtë indikator shërbejnë të dhënat të dhënat që merren nga verifikimi i faqes zyrtare online të gjykatave, si edhe të dhënat e marra nga publikimet e KLGj-së.

VI. MONITORIMI I DISPONUESHMËRISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE ADMINISTRATIVE

Disponueshmëria në vendimet gjyqësore administrative përbën një të drejtë themelore dhe të natyrshme për sa vendimi gjyqësor administrativ është jo vetëm përfundimi dhe zgjidhja e rastit/çështjes, por është njëkohësisht edhe një detyrim i pritshëm në një kohë të shpejtë.

VI.1 Faktori 1 - Institucionet përgjegjëse për informimin mbi vendimet gjyqësore

VI.1.1 Standardi i performancës

Gjykatat janë më së pari përgjegjëse për të ndërtuar një sistem disponueshmërie dhe garantuar mundësinë e palëve, publikut të interesuar dhe medias në marrjen e vendimeve gjyqësore ose dokumentacionit, në mënyrë të plotë, të saktë dhe në kohë të shpejtë.

Për këtë qëllim janë parashikuar dhe duhet të materializohen plotësisht një sërë mjetesh që tregohen në kuadrin ligjor në fuqi, e që aktualisht posedohen nga gjykatat në funksion të ndërtimit të një marrëdhënieje të hapur, transparente, të besueshme dhe të përgjegjshme me publikun dhe median.

Ndryshimet e parashikuara në paketën e ligjeve të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi parashikojnë se gjykatat duhet të krijojnë dhe përditësojnë arkivat elektronike ku duhet të mbajnë dokumentacionin elektronik. Madje, sipas vendimmarrjes së qeverisë¹⁴ për krijimin dhe organizimin e një qendre informacioni elektronik për sistemin gjyqësor, i gjithë sistemi do të bazohet në një faqe zyrtare online dhe ky sistem do të jete i centralizuar dhe efektiv për të gjitha gjykatat në Shqipëri. Fillimisht sistemi do të funksionojë dhe ofrojë si një platformë zgjidhje me një ndalesë (*one stop shop*) për të aksesuar pikërisht vendimet gjyqësore.

Pranë çdo gjykate organizohet administrata gjyqësore në përputhje me nenin 41 të ligjit nr. 98/2016.

Në gjykatën administrative, shërbimet gjyqësore janë ato shërbime që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore, duke përfshirë dokumentimin dhe veprimtari që

14. Vendim i Këshillit të Ministrave me nr. 972, datë 02.10.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin Gjyqësor”.

kryhen nga ndihmësit ligjorë, kryesekretarja dhe sekretarët gjyqësorë.

Kryesekretari gjyqësor bashkërendon dhe organizon punën dhe ndarjen e punës në zyrën e sekretarisë nën drejtimin e kancelarit të gjykatës. Kryesekretari nënshkruan vendimet gjyqësore dhe lëshon akte ose ekstrakte dhe fotokopje të njësuara me origjinalin të akteve të gjykatës.

Shërbimet për marrëdhëniet me publikun: kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që t'i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore apo t'i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik.

Gjithashtu ky shërbim është përgjegjës që të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit", në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore, si edhe që të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.

Shërbimi i arkivit gjyqësor: mban dhe administron dokumentacionin gjyqësor, i cili përfshin dosje, regjistra dhe akte të tjera gjyqësore, si dhe akte që lidhen me veprimtarinë administrative të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërorë.

Me miratimin e rregullave të reja standarde¹⁵ për organigramën dhe detyrat e përgjegjësitë e nëpunësve gjyqësorë dhe punonjësve të gjykatave administrative, të cilat kanë detajuar dhe përcaktuar strukturat përgjegjëse, emri i shërbimit në strukturën organizative është: Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë. Nëpunësi civil gjyqësor specialist i marrëdhënieve me publikun, median dhe me jashtë, në veçanti siguron në bashkërendim me kancelarin publikimin e të gjitha vendimeve gjyqësore në përputhje me ligjin dhe kujdeset që publikut t'i sigurohet sipas formës/mënyrës së miratuar nga Këshilli i Gjykatës, informacion faktik rreth statusit të gjykimit të çështjes dhe vendimeve gjyqësore.

Qendra e dokumentacionit pranë Gjykatës së Lartë, siguron transparencën dhe aksesin online të vendimeve të kësaj gjykate¹⁶. Të gjitha dokumentet zyrtare duhet të jenë të regjistruara dhe të publikuara, ndërkohë që duhet të jetë i inkurajuar publikimi në databazën elektronike.

Këto struktura duhet të sigurojnë që disponueshmëria në vendimet gjyqësore të jetë efektive dhe sipas mjeteve më të pranueshme për kërkuesin.

Njëkohësisht, këto struktura, duhet të përditësojnë databazën elektronike (përfshirë edhe

15. Vendimi nr. 148, datë 29.03.2023 i KLGj-së.

16. Neni 35 i ligjit nr.98/2016, sipas të cilit: Qendra e dokumentacionit bën: a) sigurimin e publikimit të menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale; b) analizën dhe vlerësimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe siguron publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë; c) ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe u jep gjyqtarëve, ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave. 2. Qendra e dokumentacionit punon nën mbikëqyrjen e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

vendimet e ndërmjetme me arsyetim të shkurtuar për shtyrjen e gjykimeve dhe arsyen e shtyrjes si dhe të gjitha vendimet përfundimtare, të marra nga gjykata, duke saktësuar nëse ka marrë apo jo formë të prerë).

VI.1.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të institucionet përgjegjëse për informimin mbi vendimet gjyqësore duhet të vërehen në ekzistencën e këtyre elementeve:

- Nëpunës gjyqësor përgjegjës për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun për të siguruar disponueshmërinë e vendimeve gjyqësore (të cilat gjenden ose jo online) dhe për të dhënë përgjigje për informacionet të cilat lidhen me disponueshmërinë e vendimeve gjyqësore të aksesueshme ose jo nga publiku i gjerë, si edhe vlerësimin e arsyeve për rastet kur duhet të realizohet mbrojtja e të dhënave që nuk mund të bëhen publike.
- Faqe interneti e lehtë për t'u orientuar dhe me informacion faktik mbi strukturat përgjegjëse dhe nëpunësit përgjegjës për të dhënë vendimet gjyqësore ose që të ketë të disponueshëm një funksion të mirë kërkimi për të gjetur vendimet gjyqësore.
- Përmbledhje e rregullave të gjykatës në një dokument të vetëm të thjeshtë dhe të disponueshëm, ku përfshihet informacion se ku, kur dhe si mund të merret vendimi gjyqësor pranë institucioneve përgjegjëse.

VI.1.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht me anë të konstatimit me PO/JO. Duke u bazuar në të dhënat që mund të merren në faqen e gjykatës ose edhe në ambientet e gjykatës, mund të analizohet nëse jepen të dhënat mbi institucionet përgjegjëse për disponueshmërinë e vendimeve dhe fakti nëse informacioni është i plotë dhe i përditësuar sipas ndryshimeve ligjore dhe sipas standardeve. Krahas kësaj mund të merret informacion mbi mënyrën e cila është në zbatim nga institucionet përgjegjëse në gjykatë për t'u drejtuar dhe për të paraqitur kërkesa për marrje vendimesh gjyqësore. Për shembull, a ka një formular aplikimi specifik ose të përgjithshëm për këtë qëllim?

Të dhënat: periudha e monitorimit, të dhëna nga struktura dhe organigrama e publikuar në faqen e gjykatës, të dhëna zyrtare nga raportet periodike të publikuara nga gjykata ose raportet 3-mujore¹⁷ të dërguara nga Kryetarët e Gjykatave në KLGj.

Burimi i të dhënave: Gjykata, KLGj-ja.

VI.2 Faktori 2 - shpallja dhe publikimi i vendimeve gjyqësore

VI.2.1 Standardi i performancës

Vendimet e Gjykatave jepen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe duhet të jenë publike dhe të aksesueshme për publikun.

17. Sipas vendimit të KLGj-së, nr. 25, datë 07.02.2019 "Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore".

E drejta për të aksesuar vendimet gjyqësore theksohet edhe nga ligji nr. 119/2014, i cili publikimin dhe marrjen e një vendimi e përfshin në kategorinë e informacionit që autoriteti publik duhet të vendosë në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Të gjitha vendimet e gjykatës publikohen në mënyrën dhe me mjetet e përshtatshme. Ndërsa vendimi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, me kërkesë të gjykatës që ka dhënë vendimin, publikohet i plotë, në të njëjtën mënyrë me atë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për botimin e aktit.

Me krijimin e faqeve zyrtare të web-it, vendimet e gjykatave mund të aksesohen në faqet web të gjykatave, por këto vendime rezultojnë të jenë të anonimizuar. Anonimizimi i vendimeve, vjen për shkak të Udhëzimit nr. 15 KMDHP, i cili bazohet në Ligjin nr. 9887/2008.

Pavarësisht se ky udhëzim ka si qëllim mbrojtjen e të dhënave me karakter personal dhe ruajtjen e privatësisë së individit, vihet re se vendimet gjyqësore shpesh janë plotësisht të anonimizuara, duke cenuar edhe të drejtën e qytetarëve për t'u informuar dhe për t'i aksesuar këto vendime në mënyrë elektronike.

VI.2.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të shpalljes dhe publikimit të vendimeve gjyqësore orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A ndodh publikimi online i vendimeve gjyqësore, kryesisht nga gjykata, në respektim të kërkesave për anonimizimin e tyre?
- A trajtohen qytetarët në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese nga gjykatat?
- A ka në zbatim në gjykatë një sistem funksional të teknologjisë së informacionit, i cili mundëson publikimin e të dhënave/vendimeve duke i përfshirë ato në procesin automatik të anonimizimit?

VI.2.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht në përqindje. Duke u bazuar në të dhënat që mund të merren në faqen e gjykatës ose edhe në ambientet e gjykatës, mund të merret numri i vendimeve të publikuara apo të disponueshme për publikun dhe numri i vendimeve të dhëna nga gjykata për çështjet gjyqësore që janë përfunduar dhe për të cilat është marrë një vendim nga ana e gjykatës, përgjatë periudhës së monitorimit. Duhet të mbahet parasysh se periudha e monitorimit mund të jetë relativisht e gjatë për shkak të kohës së nevojshme të përcaktuar si afat nga ligji për përfundimin e një çështjeje civile, deri në 2 vjet.

Vlera në % = numri i çështjeve për të cilat vendimet janë të publikuara online / totali i numrit të çështjeve të përfunduara me vendim nga ana e gjykatës x 100

Sa më e lartë të rezultojë vlera si më sipër, aq më mirë përmbushet detyrimi i shpalljes dhe publikimit të vendimeve.

Të dhënat: periudha e monitorimit, numri dhe lloji i vendimeve të gjykatës, statistika ose të dhëna zyrtare nga raportet periodike të publikuara nga gjykata.

Burimi i të dhënave: Gjykata, KLGj-ja.

VI.3 Faktori 3 – korrigjimi i gabimeve në vendim dhe interpretimi i tij

VI.3.1 Standardi i performancës

Nevoja për plotësim apo korrigjim në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në vendimin e gjykatës përbën edhe një nga treguesit e shkallës së aftësisë së gjyqtarit.

Gjykatat, në çdo kohë, duhet të ndreqin çdo gabim të bërë në shkrim, në llogari ose në lidhje me ndonjë pasaktësi të dukshme në vendim. Po kështu, gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët.

Është detyrë e nëpunësit civil gjyqësor, specialist i marrëdhënive me publikun, mediat dhe me jashtë, të kujdeset që publikut t'i sigurohet sipas formës/mënyrës së miratuar nga Këshilli i Gjykatës, informacion faktik rreth statusit të gjykimit të çështjes, vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara.

VI.3.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të korrigjimit të gabimeve në vendim dhe sqarimin e tij, orientohen nga përgjigjet e këtyre pyetjeve:

- A ka informacion të publikuar dhe lehtësisht të aksesueshëm nga publiku në lidhje me të drejtën e palëve për të kërkuar dhe kryer korrigjimin e gabimeve në vendimin e gjykatës ose për të kërkuar sqarimin e tij?
- A publikohen vendimet e gjykatës në përgjigje apo zgjidhje të kërkesave të palëve për korrigjimin/sqarimin e vendimit gjyqësor?

VI.3.3 Metoda e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion: në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë, i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

Të dhënat: periudha e monitorimit, numri dhe lloji i kërkesave të palëve për korrigjim/sqarim vendimi gjyqësor të cilat janë pranuar nga gjykata, statistika.

Burimi i të dhënave: Gjykata, KLGj-ja.

VI.4 Faktori 4 – koha për disponueshmërinë e vendimeve

VI.4.1 Standardi i performancës

Kohëzgjatja e arsyetimit të vendimit nënkupton kohën nga momenti i shpalljes së dispozitivit në seancë e deri kur vendimi dorëzohet bashkë me dosjen gjyqësore në sekretarinë e gjykatës.

Koha për disponueshmërinë e vendimeve është e lidhur drejtpërdrejt me procesin e rregullt ligjor dhe detyrimet që imponon neni 6 i KEDNj-së. Në dallim nga ecuria dhe koha e procesit gjyqësor, ku pavarësisht se rolin kryesor e luan gjyqtari, palët kanë të drejtë të shprehen dhe të ndikojnë edhe përmes avokatëve të tyre në këta hapa proceduralë, në arsyetimin, zbardhjen dhe dorëzimin e vendimit gjyqësor në dosje dhe sistem elektronik të disponueshëm për palët, roli i përket tërësisht dhe vetëm gjyqtarit. Këtu përgjegjësia për vonesa është vetëm e gjyqtarëve. Gjyqtarët kanë detyrimin ligjor për të përmbushur prioritetin e respektimit të të drejtave të mbrojtura nga neni 6 i KEDNj-së dhe legjislacioni vendas lidhur me gjykimin e shpejtë dhe mundësimin e pajisjes së qytetarit me një vendim.

Në vijim, dorëzimi i vendimit në kohën e caktuar është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, sepse kështu mundësohet edhe e drejta e palës për të ushtruar të drejtën e ankimit nga një gjykatë më e lartë.

Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar. Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

VI.4.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të kohës për disponueshmërinë e vendimeve mund të merren nga përgjigjet e këtyre pyetjeve:

- Sa është numri i vendimeve gjyqësore ose përqindja e tyre, të dorëzuara në sekretarinë e gjykatës brenda afatit ligjor?
- A shënohet në sekretarinë gjyqësore një Regjistër i posaçëm i Vendimeve Administrative dhe a shënohen në këtë regjistër (krahas të dhënave të tjera) data e dhënies së vendimit dhe data e dorëzimit të këtij vendimi në sekretari?

VI.4.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht në përqindje. Për matjen e tij duhet që, bazuar në të dhënat e disponueshme në Regjistrin e Vendimeve Administrative, të llogaritet në përqindje numri i rasteve kur vendimi gjyqësor është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore brenda afatit ligjor, përgjatë periudhës së monitorimit, në raport me numrin total të vendimeve gjyqësore që janë marrë nga gjykata:

Vlera në % = Numri i vendimeve gjyqësore të dorëzuara brenda afatit ligjor / numri i përgjithshëm i vendimeve gjyqësore gjatë periudhës raportuese x 100

Të dhënat:

- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore për të cilat gjykata ka marrë vendim të arsyetuar dhe e ka publikuar këtë vendim online (ose jo) për periudhën e monitorimit;
- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore për të cilat është marrë vendim, për periudhën e monitorimit;

Burimi i të dhënave: Si burim për këtë indikator shërbejnë të dhënat që merren nga Regjistri i Vendimeve Administrative që mban sekretaria gjyqësore, si edhe nga verifikimi i faqes zyrtare online të gjykatave.

VI.5 Faktori 5 - Lehtësia e kërkimit në bazat e të dhënave përkatëse nga publiku i gjerë

VI.5.1 Standardi i performancës

Aksesi në çështjet gjyqësore, kërkon fillimisht që publiku të ketë informacion të plotë, të saktë dhe të përditësuar për çështjet që janë duke u gjykuar nga gjykata. Gjithashtu, qytetari duhet të marrë në kohë dhe të aksesojë vendimet e gjykatës. Për këtë, është e nevojshme që çdo gjykatë të ketë të digjitalizuar dhe funksionale arkivin elektronik gjyqësor¹⁸. Gjithashtu, për shkak të rolit të Vendimeve të Gjykatës së Lartë në njësimin e praktikës gjyqësore, Qendra e Dokumentacionit pranë kësaj gjykate duhet të sigurojë transparencën dhe aksesin *online* të vendimeve të kësaj gjykate¹⁹.

Po kështu, gjykatat duhet të garantojnë që çdo person të ketë akses të barabartë në gjykatë, si për sa i përket informacionit dhe dokumentacionit që ajo administron, ashtu dhe sa i takon mbrojtjes të të drejtave të tyre ligjore dhe trajtimit të tij pa asnjë diskriminim në proceset gjyqësore.

VI.5.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të lehtësisë e kërkimit në bazat e të dhënave përkatëse nga publiku i gjerë orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A publikojnë gjykatat në faqen e vet në internet të dhëna për çështjet gjyqësore të gjykuara, si dhe ato në proces?
- A është informacioni i publikuar në faqen elektronike të gjykatës për çështjet gjyqësore në proces i përditësuar, sipas fazës së gjykimit?
- A mund të aksesojë publiku, dokumentet e një dosjeje gjyqësore, në përputhje me parashikimet e ligjit?
- A janë të digjitalizuara arkivat gjyqësore?
- A ka programe që i shërbejnë publikut të gjerë, për të kuptuar rolin e gjykatës dhe vendosjen e marrëdhënieve me gjykatën?
- A trajtohen qytetarët në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese nga gjykatat?

VI.5.3 Metodat e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion: në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit

18. Shih nenin 48 të Ligjit nr.96/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

19. Shih nenin 35 të ligjit nr.98/2016.

të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë, i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

VI. 6 Faktori 6 - Përmbledhje e ecurisë së rasteve dhe / ose kronologjia e rasteve

VI.6.1 Standardi i performancës

Sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efiçencës, në përputhje me nenin 2 të Ligjit nr. 115/2016.

Palët në proces janë sigurisht më të interesuarat dhe duhet të kenë informacion online, në mënyrë që të jenë në dijeni për statusin e çështjes së tyre dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga ana e gjykatës. Nga ana tjetër, edhe publiku duhet të ketë informacion për çështjet gjyqësore që shqyrtohen nga gjykata, objektin e tyre, statusin, kohëzgjatjen, ecurinë e çështjes, dispozitivin e vendimeve.

Kështu matet dhe monitorohet veprimtaria e gjykatës, si nga palët pjesëmarrëse në proces, ashtu edhe nga publiku i gjerë. Është e rëndësishme që informacioni bazë jo vetëm të jetë online, për të gjitha çështjet në shqyrtim, por edhe i përditësuar.

Kështu matet indirekt edhe respektimi i parimit të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, i cili ka një rëndësi themelore për gjykimin administrativ, pasi përbën edhe një nga elementet e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

VI.6.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit, te përmbledhja e ecurisë së rasteve / kronologjia e rasteve orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A publikojnë gjykatat në faqen e vet në internet të dhënat e ecurisë ose kronologjinë për çështjet gjyqësore në proces?
- A është informacioni i publikuar në faqen elektronike të gjykatës për çështjet gjyqësore në proces i përditësuar, sipas fazës së gjykimit?
- A ka të publikuara në faqen e gjykatës deklarata për shtyp të cilat tregojnë përmbledhje të çështjeve gjyqësore dhe ecurinë e tyre?

VI.6.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes së këtij faktori mund të jepet lehtësisht në përqindje. Për matjen e tij duhet që, bazuar në të dhënat e disponueshme në faqen e gjykatës, të llogaritet në përqindje numri i rasteve kur informacioni bazë në lidhje me ecurinë e rasteve është i disponueshëm në internet dhe i përditësuar, përgjatë periudhës së monitorimit, në raport me numrin e çështjeve gjyqësore që janë duke u shqyrtuar nga gjykata:

Vlera në % = Numri i çështjeve gjyqësore në vazhdim me informacionin themelor të azhornuar sipas kronologjisë së rastit të disponueshëm publikisht / numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces gjatë periudhës raportuese x 100

Për matjen e këtij indikatori ka rëndësi të vlerësohet nëse informacioni për çështjet jepet në të gjithë komponentët kryesorë, si edhe nëse është i përditësuar në kohë.

Të dhënat:

- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces me informacion themelor të azhornuar sipas kronologjisë të disponueshëm publikisht online për periudhën e monitorimit;
- Numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore në proces me informacion themelor të azhornuar sipas kronologjisë të disponueshëm publikisht online dhe të përditësuar, për periudhën e monitorimit;

Burimi i të dhënave: Si burim për këtë indikator shërbejnë të dhënat të dhënat që merren nga verifikimi i faqes zyrtare online të gjykatave, si edhe të dhënat e marra nga publikimet e KLGj-së.

VII. MONITORIMI I TË DREJTËS PËR AKSES NË DOKUMENTET DHE NË DOSJET E GJYKATËS PËR PALËT NË GJYKIM DHE PALËT E INTERESUARA

VII.1 Faktori 1 - Qasja në informacionin publik dhe transparencë në gjyqësor

VII.1.1 Standardi i performancës

Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit.

Aksesi në drejtësi, kërkon që qytetarët dhe përdoruesit e gjykatës të kenë informacionin dhe orientimin e nevojshëm për të aksesuar gjykatat qoftë fizikisht, qoftë virtualisht nëpërmjet faqeve të tyre në internet. Kontakti i qytetarit me gjykatat dhe pjesëmarrja e tij apo e medias për aq sa e lejon ligji, në sallat apo seancat gjyqësore personalisht apo nëpërmjet teknologjisë së informacionit, është parakusht i aksesit në drejtësi dhe garantimit të një drejtësie cilësore. Seancat gjyqësore janë publike, përndryshe janë të pavlefshme, mirëpo nga ana tjetër KPP ka parashikuar një sërë rastesh kur gjykimi zhvillohet me dyer të mbyllura dhe konkretisht:

- a) kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit, në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga organi kompetent;
- b) kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës;
- c) kur është e nevojshme të mbrohet siguria e dëshmitarëve ose e të pandehurve;
- ç) kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve si dëshmitarë;
- d) kur viktimat e përcaktuar në nenin 58/b, të këtij Kodi, kërkon të zhvillohet me dyer të mbyllura.

Shqyrtimi gjyqësor zhvillohet gjithmonë me dyer të mbyllura²⁰ kur:

- a) gjykohen të miturit;
- b) gjykohen të pandehur të rritur, të cilët akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë, pavarësisht moshës së viktimës gjatë gjykimit.

20. Neni 58 i KPP-së: Kryetari i trupit gjykues informon personat që marrin pjesë në një gjykim me dyer të mbyllura për detyrimin që kanë për të mbajtur konfidencial informacionin e mësuar në seancë. Gjithashtu, edhe shqyrtimi i kërkesës për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve pjesëmarrëse në proces.

Garantimi i aksesit në veprimtarinë gjyqësore kërkon të drejtën për t'ujohur me veprimtarinë gjyqësore dhe dokumentacionin e administruar nga gjykata, si dhe për të përfituar nga shërbimet gjyqësore. Është e rëndësishme që publiku të jetë i informuar për shkallët dhe juridiksionet e gjyqësorit, afatet dhe mjetet procedurale, më të cilat i drejtohet gjykatës, të ketë informacion dhe akses për ndihmën juridike, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

VII.1.2 Treguesit e realizimit

Këshilli i Lartë Gjyqësor, për t'i ardhur në ndihmë publikut në lidhje me transparencën në gjyqësor dhe aksesin e këtyre të fundit në gjykatë, ka krijuar faqen e internetit gjykatat.gov.al ku janë të pasqyruara të gjitha gjykatat shqiptare.

Të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit, dhe Gjykatat e Juridiksionit të Përgjithshëm, disponojnë faqen e tyre të internetit, ku i mundësojnë publikut akses në lidhje me veprimtarinë e tyre dhe transparencën gjyqësore.

Faqet e internetit të gjykatave janë:

- Lehtësisht të përdorshme jo vetëm nga avokatët, por edhe nga publiku i gjerë;
- Të aksesueshme edhe nëpërmjet telefonave celularë;
- Të aksesueshme nëpërmjet shfletuesve të ndryshëm të faqeve të internetit (browser), si Chrome, Explorer, Firefox, etj.

Faqet e internetit të gjykatave përfshijnë:

- Informacion për të udhëzuar qytetarët që nuk përfaqësohen nga një avokat, se si duhet t'i drejtohen gjykatës për të nisur një proces gjyqësor;
- Informacion lidhur me aksesin në gjykatë, përfshirë aksesin për të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe;
- Informacion lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti, subjektet përfituese të ndihmës juridike dytësore, procedurën e depozitimit dhe shqyrtimit të kërkesës nga gjykata;
- Informacion lidhur me tarifat gjyqësore;
- Informacion lidhur me procedurën e depozitimit dhe shqyrtimit të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore;
- Informacion lidhur me afatin dhe mënyrën se si mund të ushtrohet e drejta e ankimit/rekursit ndaj një vendimi gjyqësor;
- Përgjigjet për ankesat;
- Formularët që mund të plotësohen dhe dorëzohen në internet (online).

Faqet e internetit përqendrohen në nevojat dhe pyetjet e përdorueseve të gjykatës.

Faqet e internetit janë të organizuara në mënyrë të tillë që të jetë e lehtë për të gjetur informacionet që kërkohen më shpesh, d.m.th. të kenë një funksion të mirë kërkimi, për të gjetur vendimet gjyqësore, shortin e çështjeve gjyqësore, kalendarin e seancave gjyqësore, kontaktet e gjykatës, programin e transparencës, si dhe informacione të tjera me interes për publikun.

Faqet e internetit janë të përditësuara në mënyrë të vazhdueshme dhe informacioni në përmbajtje të tyre duhet të jetë i saktë.

Faqet e internetit përmbajnë rregullat që duhet të zbatohen nga publiku, përfshirë përfaqësuesit e medias, në mënyrë që ata të jenë të informuar paraprakisht, p.sh. nëse do të mund të kryhen fotografime, regjistrime, filmime, apo veprime të tjera, në mjediset e gjykatës.

Faqet e internetit shërbejnë edhe si mundësi komunikimi të ndërsjellë e të vazhdueshëm me publikun, ku kërkesat, komentet, apo pyetjet e publikut do të përdoren si instrumente matës për cilësinë e ofrimit të informacionit.

VII.1.3 Metoda e matjes

Instrumenti matës për cilësinë e ofrimit të këtij informacioni është marrë bazuar në të dhënat që jepen në faqen e gjykatave, po ashtu edhe në sportelet e gjykatave. Ky informacion analizohet duke u bazuar tek aksesit në gjykata nëpërmjet faqes online të tyre, i cili është lehtësisht i aksesueshëm duke shfaqur gjithashtu edhe informacione të përditësuara në lidhje me çështjet civile apo penale në gjykim, lista e çështjeve për gjykim, rregulloret e gjykatës, programi i transparencës, njoftime për mediat apo për publikun. Aksesit në gjykatë është lehtësisht i vlerësueshëm me cilësimin PO/JO.

Burimi i të dhënave: faqet zyrtare të gjykatave; raporte zyrtare të KLGj-së.

Shih për më tepër Rregulloren nr.1049/ 30 Maj 2001 e (KE) “Mbi aksesin e publikut në dokumentacionin e Këshillit, Parlamentit dhe Komisionit Evropian”;

Shih për më tepër Rekomandimin no. R (2003) e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi arkivimin e dokumenteve elektronike në sektorin e drejtësisë”.

VII.2 Faktori 2 - Transparenca dhe pavarësia gjyqësore

VII.2.1 Standardi i performancës

Transparenca e veprimtarisë gjyqësore është e rëndësishme për t’u vlerësuar, pasi ndikon në:

- (i) vendimmarrje të drejta, të paanshme dhe të ndershme;
- (ii) rritjen e llogaridhënies së pushtetit gjyqësor;
- (iii) rritjen e aksesit të qytetarëve te drejtësia;
- (iv) rritjen e besimit të publikut te pushteti gjyqësor.

Si çdo institucion tjetër publik, gjykatat duhet të garantojnë zbatimin e Ligjit nr. 119/2014.

Në përgatitjen e projekt programit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos: a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik; b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion; c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të Ligjit nr. 119/2014.

Në zbatim të tij, KLGj-ja dhe gjykatat duhet të përmbushin një sërë detyrimesh:

Së pari, KLGj-ja duhet të ketë një portal elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për qasjen në drejtësi, përfshirë informacion të detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik. Gjithashtu secila gjykatë duhet të ketë hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet dhe t'i lejohej të publikojë në të të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore.

Së dyti, KLGj-ja duhet t'i ofrojë publikut të dhëna që pasqyrojnë në mënyrë reale aspekte që lidhen me performancën e gjyqësorit. Përveç KLGj-së, edhe gjykatat e çdo niveli dhe juridiksioni, është e rëndësishme të publikojnë në faqen zyrtare të tyre të dhënat statistikore.

Së treti, KLGj-ja dhe gjykatat duhet të sigurojnë informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. Ato gjithashtu duhet të caktojnë personin përgjegjës që do të kryejë detyrën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, i cili mban marrëdhënie të vazhdueshme me mediat dhe publikun lidhur me kërkesat e tyre për informacion. KLGj-ja dhe gjykatat duhet të kujdesen të zbatojnë me përpikëri procedurat dhe afatet e caktuar në ligjin "Për të drejtën e informimit", me qëllim që qytetari të marrë në kohë çdo informacion të kërkuar prej tyre, të garantuar nga ligji.

Së katërti, KLGj-ja dhe gjykatat duhet të miratojnë Programin e Transparencës, i cili jep informacion pa kërkesë, mbi: organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e kryer nga KLGj-ja; anëtarët dhe stafin e KLGj-së; kuadrin rregullator; aksesimin e KLGj-së; monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së KLGj-së; mekanizmat e përfshirjes në vendimmarrje; mënyrat e aksesimit të dokumentacionit; si dhe informacion për prokurimet, për buxhetin dhe planin e shpenzimeve, etj. Është e rëndësishme që informacioni i kërkuar nga ligji për të drejtën e informimit të jetë i plotë, i saktë, i përditësuar në kohë sa më të shpejtë, i lehtë për t'u aksesuar dhe kuptuar, dhe njëkohësisht i vërtetë. Nga ana tjetër duhet të garantojë në mënyrë rigoroz zbatimin e detyrimeve ligjore mbi konfidencialitetin, sekretin shtetëror, privatësinë etj. Programi i transparencës duhet të japë informacionin e nevojshëm lidhur me të drejtën që kanë qytetarët për t'u ankuar te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

VII.2.2 Treguesit e realizimit

Disa konsiderata paraprake:

Portali elektronik i KLGj-së ofron informacionin e duhur për qytetarët lidhur me veprimtarinë e KLGj-së, legjislacionit, strukturën e gjyqësorit, dokumentimin e mbledhjeve plenare si dhe publikimin e regjistrimit audio të tyre. Po ashtu portali elektronik i KLGj-së ofron programin e transparencës mbi shqyrtimin e praktikave korruptive, dhe mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Gjithashtu portali i KLGj-së ofron Raporte të KLGj-së, Akte Normative Nënligjore, Akte Administrative Kolektive, Akte Administrative Individuale, Rregulla të brendshme, Udhëzime dhe Opinione.

Portali elektronik i KLGj-së ofron informacion edhe sa i përket strukturës së gjyqësorit, ku në krye të kësaj strukture qëndron Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, Gjykatat e Apelit Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, Gjirokastrë, Krujë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Gjykatat e Rretheve Lezhë, Dibër, Berat, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Krujë, Fier, Elbasan, Përmet, Pogradec, Pukë, Kurbin, Lushnjë, Kavajë, Sarandë, Shkodër, Mat, Vlorë, Tropojë, Tiranë. Kjo strukturë organizative do të përditësohet në momentin e finalizimit të hartës së re gjyqësore. Duke qenë se harta e re gjyqësore është finalizuar, struktura gjyqësore në portalin elektronik të KLGj-së ende nuk është finalizuar.

Informacioni që shfaqet publikisht në portalin elektronik sa i përket veprimtarisë së KLGj-së është i plotë koherent dhe i përditësuar. E vetmja mangësi mbetet mosfinalizimi i strukturës gjyqësore (*klgj.al – rreth nesh – struktura e gjykatës*), e cila pritet të azhurnohet së shpejti pasi tashmë është miratuar edhe harta e re gjyqësore.

Në funksion të kompetencave që Këshilli i Lartë Gjyqësor është i ngarkuar sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si një strukturë e re kushtetuese, administron të dhëna statistikore për sistemin gjyqësor nga momenti i krijimit të saj, pra nga viti 2018 e në vijim. Konkretisht, është krijuar Regjistri për regjistrimin e kërkesave për të drejtën e informimit ku Këshilli mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore sipas vendimeve të miratuara prej saj, vendimi nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore” dhe vendimi nr. 47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e “Udhëzuesit “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave”, të cilat përmbajnë të dhëna në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë. Në zbatim të vendimit nr. 47 datë 11.02.2021 të KLGj-së, raportohen nga gjykatat statistika vjetore mbi çështje familjare në tërësi dhe nuk klasifikohen sipas natyrës specifike të tyre. Sa më sipër KLGJ-ja, gjendet në pamundësi për të dhënë informacionin e kërkuar. Ministria e Drejtësisë është autoriteti i cili ka administruar

të dhënat statistikore të gjykatave përpara krijimit të Këshillit, si dhe institucioni kompetent për përpunimin e statistikave vjetore për çështjet gjyqësore.

Në funksion të kompetencave të lartpërmendura, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 592, datë 26.11.2020 "Për Miratimin e Rregullores Për Komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me Median", vendosi miratimin e kësaj Rregulloreje, duke caktuar anëtarin e Këshillit, për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun. Në mbështetje të kësaj rregulloreje është caktuar "Koordinatori për të drejtën e Informimit", i cili është Koordinator i Këshillit, i caktuar në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit".

Vendosja e kontaktit dhe komunikimit realizohet nëpërmjet një adrese të posaçme të postës elektronike media@klgj.al e cila përdoret nga Koordinatorin për të drejtën e Informimit. Në faqen zyrtare të KLGj-së caktohet një rubrikë e veçantë me emërtimin "Kontakti me Mediat".

Në portalin elektronik të KLGj-së, në rubrikën Programi i Transparencës, i miratuar në mbështetje të ligjit Nr. 9508 datë 3.4.2006 "Për Bashkëpunimin e Publikut në Luftën Kundër Korrupsionit", dhe Vendimit Nr. 441, datë 05.10.2021, Për Miratimin e Rregullores "Për Shqyrtimin e Praktikave Korruptive në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme për publikun.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale publikon çdo vit listën e plotë të ankesave në portalin pyetshtetin.al në të cilën publiku mund të konsultohet lehtësisht në lidhje me Regjistrin e Ankesave. Në regjistrin e ankesave të vitit 2022, drejtuar Komisionerit Publik kundër Gjykatave të Republikës së Shqipërisë rezultoi të jenë dërguar në total 17 ankesa, ku 2 ankesa janë adresuar kundër Gjykatës së Lartë, 1 ankesë kundër Gjykatës së Posaçme Apelit Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, 3 kundër Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, 2 kundër Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 3 kundër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 1 kundër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, 2 kundër Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, 3 kundër Gjykatës së Apelit Vlorë.

Treguesit e realizimit të transparencës dhe pavarësisë orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A ofron portali elektronik i KLGj-së informacionin e duhur për qytetarët lidhur me veprimtarinë e KLGj-së, legjislacionin, strukturën e gjyqësorit, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si dhe çdo çështje tjetër me rëndësi për publikun?
- A ka çdo gjykatë hapësirën e saj në portalin në internet të KLGj-së ku jep informacion, pa kërkesë, për gjykatën dhe veprimtarinë e saj?
- A është informacioni që shfaqet publikisht në portalin elektronik i plotë dhe i përditësuar?
- A ka faqja në internet e KLGj-së të publikuar të dhëna për performancën e gjyqësorit,

në gjuhë të kuptueshme për publikun?

- A ka faqja në internet e KLGj-së dhe e gjykatave statistika që pasqyrojnë veprimtarinë e gjykatave, në gjuhë të kuptueshme për publikun?
- A ka caktuar KLGj-ja dhe gjykatat një person përgjegjës që mbulon përgjegjësitë e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit?
- A ka KLGj-ja dhe gjykatat të publikuar në faqen e saj zyrtare Programin e Transparencës?
- A është informacioni i gjeneruar në Programin e Transparencës i plotë, i përditësuar, i saktë dhe lehtësisht i aksesueshëm?
- Në trajtimin e kërkesave të palëve dhe të publikut për informacion, a ka barriera të pajustificueshme administrative apo të ndonjë lloji tjetër?
- A paraqesin qytetarët ankime te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me të drejtat e tyre për informim drejtuar KLGj-së apo gjykatave? Për çfarë arsye bëhen ankimet?
- A ka gjetur shkelje Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për rastet kur qytetarët ankohen mbi mosmarrjen e informacionit të kërkuar apo tej afateve nga KLGj-ja apo gjykatat?

VII.2.3 Metoda e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

Një mënyrë tjetër për të vlerësuar treguesit e realizimit të mësipërm është nëpërmjet marrjes nga faqja e Komisionerit, apo në rrugë zyrtare informacion mbi ankesat dhe vendimmarrjet e Komisionerit për ankesat e drejtuara ndaj KLGj-së dhe gjykatave.

Një mënyrë tjetër efektive për vlerësimin e treguesve të mësipërm është nëpërmjet sondazheve dhe pyetësorëve, të cilat matin perceptimin e qytetarëve, medias, përdoruesve të gjykatave, mbi shkallën e informacioneve që kanë rreth tyre, dhe se sa e vlerësojnë nivelin e aksesit në kalendarin e seancave gjyqësore.

Burimi i të dhënave:faqe zyrtare e KLGj-së, faqe zyrtare të gjykatave.

VII.3 Faktori 3 - Aksesit në informacionin publik në gjykata

VII.3.1 Standardi i performancës

Përmbajtja e dosjes gjyqësore është shumë e rëndësishme për gjykimin me qëllim garantimin e një procesi të drejtë. Përgjegjësinë për mbajtjen e dosjes e ka gjyqtari dhe një nga kriteret e vlerësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është edhe aftësia e gjyqtarit për të strukturuar

përmbajtjen e dosjes që ta bëjë atë lehtësisht të shfrytëzueshme.

Sekretari i seancës është gjithashtu përgjegjës për të lidhur dhe numërtuar faqet në përfundim të çdo seance gjyqësore, apo sa herë paraqitet një akt i ri, ndërkohë që sekretari gjyqësor duhet të kontrollojë numërtimin e fletëve dhe plotësimin e inventarit të dosjes.

Përmbajtja e dosjes gjyqësore, konsiderohet si informacion me akses të kufizuar, i cili përkufizohet si “e dhënë që gjendet në dokumentet e administruara nga gjykata, dhënia e të cilit për publikun mund të refuzohet”. Publikut mund të mos i jepet akses në informacionin që përmban dosja gjyqësore nëse përmbajtja e saj është konfidenciale sipas ligjit apo nëse cenohet ecuria e procesit gjyqësor. Aplikimi për marrjen e kopjes së dosjes gjyqësore paraqitet në ZMP, gjithmonë me shkrim, e cila ia vë në dispozicion menjëherë kryetarit të gjykatës. Vendimin për të dhënë akses e merr kryetari i gjykatës ose trupi gjykues, sipas rastit.

VII.3.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit në lidhje me faktorin.

Aksesi në informacionin publik në gjykata, orientohet nga përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme:

- A ka në faqen online të gjykatës informacion ose fizikisht pranë sporteleve të gjykatës informacion mbi mënyrën e aksesit në informacionin publik dhe/ose kërkesa tip për këtë qëllim?
- A është ky informacion i përgjithshëm apo specifikisht i qartë në lidhje me efektivitetin e kërkimit të paraqitur nga qytetari?

VII.3.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes për këtë faktor është me konstatim PO/JO.

Të dhënat: faqe zyrtare e gjykatave

Burimi i të dhënave: Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë, i përditësuar.

VII.4 Faktori 4 - Monitorimi i caktimit të çështjeve për gjyqtarë

VII.4.1 Standardi i performancës

Ndarja e çështjeve gjyqësore me short bëhet bazuar në nenin 25 të Ligjit nr. 98/2016. Shorti realizohet në rrugë elektronike, bazuar në parimet e transparencës dhe të objektivitetit. Kancelari i gjykatës mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruan përcjelljen e praktikës së çështjes

gjyqësore te gjyqtari i caktuar.

Rregullat e hollësishme për programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short, miratohen nga KLGj-ja të cilat në veçanti përcaktojnë:

a) programin për organizimin e shortit, me qëllim që të disponojë karaktere dhe parametra të mjaftueshëm, të cilët sigurojnë standardet më të larta të transparencës dhe të kapaciteteve të gjurmimit; b) mënyrën transparente të dokumentimit të përgatitjes së shortit; c) afatet e organizimit të shortit dhe mënyrën e njoftimit paraprak të tij; ç) kriteret për sigurimin e ndarjes së drejtë të çështjeve ndërmjet gjyqtarëve; d) rastet dhe kriteret e rindarjes së çështjeve me short, kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara; dh) kriteret transparente dhe objektive për procedurën e përjashtimit të gjyqtarëve nga shorti për shkak të ngarkesës ose për shkak të angazhimit të gjyqtarëve në veprimtari të tjera në funksion të gjykatës apo të pushtetit gjyqësor; e) kriteret transparente dhe objektive për ndarjen e çështjeve në rast mosfunksionimi të sistemit elektronik të çështjeve.

VII.4.2 Treguesit e realizimit

Disa konsiderata paraprake:

Me vendimin Nr. 554, datë 29.12.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi “Për Ndarjen me Short të Çështjeve Gjyqësore”. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve dhe rregullave të hollësishme për ndarjen e çështjeve gjyqësore me short, në të gjitha nivelet e gjykatave në Republikën e Shqipërisë. Rastet dhe kriteret e rindarjes së çështjeve me short, do të rregullohen me një akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndarja e çështjeve gjyqësore me short realizohet mbi bazën e parimit të transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit, barazisë së shpërndarjes dhe objektivitetit.

Zhvillimi i shortit në njësi përpunimi dhe ruajtje kryhet nëpërmjet algoritmeve që vërtetojnë autenticitetin e shortit, integritetin e të dhënave, sigurinë dhe auditimin e tyre. Sistemi elektronik i shortimit auditohet në mënyrë të automatizuar, nëpërmjet verifikimit të ekuivalencës së rezultatit të ruajtur lokalisht me atë në sistemin qendror dhe verifikimit të kodeve për të garantuar integritetin e bllokut të informacionit të ruajtur.

Çështjet gjyqësore, me paraqitjen në gjykatë, regjistrohen menjëherë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive të sistemit, nën mbikëqyrjen e kryesekretarit dhe kancelarit. Ndarja e çështjeve me short, si rregull, realizohet çdo ditë pune në rrugë elektronike me anë të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Në rast pamundësie të realizimit të shortit brenda ditës së punës, çështjet e regjistruara shorthohen jo më vonë se dita e nesërme e punës. Raporti i shortimit është publik dhe pasqyrohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. Çështjet gjyqësore u ndahen në mënyrë të barabartë gjyqtarëve, sipas organizimit të brendshëm të gjykatës. Në çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, shorti për caktimin e gjyqtarit të çështjes, hidhet ndërmjet gjyqtarëve të seksionit përkatës.

Në mungesë të këtij të fundit, shorti hidhet ndërmjet gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e këtyre çështjeve penale. Ndarja e çështjeve gjyqësore me short pezullohet gjatë procesit të mbartjes së dosjeve si dhe gjatë lejes vjetore në muajin gusht. Afati i pezullimit përcaktohet me vendim të arsyetuar të Kryetarit të Gjykatës. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon periodikisht manualin e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, përfshirë rubrikën e shortimit elektronik.

Gjithashtu, Nr. 554, datë 29.12.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka parashikuar edhe përjashtimin e çështjeve gjyqësore nga shorti të cilat janë:

Përjashtohen nga ndarja me short:

- a) Kërkesat për të cilat ligji parashikon afate shqyrtimi, jo më shumë se 72 orë për gjykatën e shkallës së parë dhe jo më shumë se 10 ditë për gjykatën e apelit, të cilat shqyrtohen nga gjyqtarët e listës së gatishmërisë, në zbatim të shkronjës “b”, të nenit 37, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- b) Kërkesat e paraqitura rishtazi, për të cilat ligji procedural parashikon shqyrtimin nga gjyqtari i hetimeve paraprake apo nga gjyqtari i seancës paraprake;
- c) Çështjet e caktuara me short, për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar, si edhe çdo vendim tjetër, që pa e zgjidhur çështjen në themel, i jep fund procesit gjyqësor të filluar sipas ligjit;
- d) Çështjet gjyqësore për të cilat është pranuar gjykimi i shkurtuar;
- e) Çdo kërkesë apo çështje gjyqësore për të cilat ligji ka parashikuar shqyrtimin nga i njëjti trup gjykues.

Po ashtu, ky vendim parashikon edhe “Përjashtimin e gjyqtarit nga shorti”, Përjashtohet nga shorti gjyqtari, i cili ndodhet përpara njëres prej pengesave ligjore të tilla si:

- a) Gjyqtari që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë gjykimi përjashtohet nga shorti në shkallët e tjera;
- b) Gjyqtari që ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit përjashtohet nga shorti në rigjykim, përveçse kur është urdhëruar ndryshe nga një gjykatë më e lartë;
- c) Gjyqtari që ka shqyrtuar në themel kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, përjashtohet nga shorti për të gjykuar kërkesat në seancë paraprake dhe kërkesat në gjykimin në themel të çështjes;
- d) Gjyqtari i seancës paraprake përjashtohet nga shorti për kërkesat në gjykimin në themel të çështjes, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Një tjetër procedurë e ndarjes së çështjeve me short është edhe ajo e “Ndarjes së çështjeve me short manual”.

Në rastin kur sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk funksionin në mënyrë të dokumentuar, për më shumë se dy ditë pune, ndarja e çështjeve realizohet përmes shortit manual.

Ndarja e çështjeve me short manual realizohet nga Kancelari, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Gjykatës, si dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve të gjykatës, pasi janë njoftuar paraprakisht për zhvillimin e shortit manual.

Procedura e ndarjes së çështjeve me short manual dokumentohet në procesverbal dhe publikohet në faqen e internetit të gjykatës. Në çdo rast një kopje e procesverbalit të dokumentimit të procedurës së shortit manual bëhet pjesë e fashikullit të gjykimit.

Procesi i shortimit për ndarjen e çështjeve realizohet në sallë gjykimi dhe shfaqet në kohë reale në monitorët e vendosur në ambientet e hyrjes së gjykatës për aq sa është e mundur. Raporti i shortimit është publik dhe pasqyrohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.

Treguesit e realizimit të caktimit të çështjeve për gjyqtarë orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- ✓ A janë miratuar nga KLGj-ja rregullat e hollësishme bazuar në standardet e nenit 25 të Ligjit nr. 98/2016 për caktimin e çështjeve gjyqtarëve me short?
- ✓ A lejohen mediat/ shoqëria civile, personat e interesuar, që të ndjekin procedurën e hedhjes në short?
- ✓ A ka në faqen online të gjykatës informacion mbi datat e hedhjes së shortit apo rezultate të hedhjes së shortit?

VII.4.3 Metoda e matjes

Metoda e matjes për këtë faktor është me konstatim PO/JO.

Të dhënat: faqe zyrtare e gjykatave, faqe zyrtare e KLGj-së.

Burimi i të dhënave: për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion: në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë, i përditësuar.

VIII. MONITORIMI I AKSESIT NË INFORMACION DHE PRAKTIKAT E TRANSPARENCËS NË FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM DHE ASPEKTET ADMINISTRATIVE TË GJYQËSORIT

VIII.1 Faktori 1 - Informacion mbi menaxhimin e fondeve publike (buxhetet, shpenzimet prokurimi)

VIII.1.1 Standardi i performancës

Financimi i përshtatshëm i pushtetit gjyqësor është një faktor determinant, që ndikon në pavarësinë objektive të tij. Megjithëse financimi i gjykatave është pjesë e buxhetit të shtetit, një financim i tillë nuk duhet të jetë subjekt ndikimeve politike dhe ndarja e fondeve duhet të bazohet në respektim të plotë të pavarësisë së gjyqësorit.

Nga ana tjetër, shteti duhet të sigurojë burimet financiare, të ardhurat, si dhe pajisjet e duhura me qëllim që gjykatat të funksionojnë në përputhje me standardet e përcaktuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe t'u mundësojë gjyqtarëve dhe stafit të gjykatave të punojnë në mënyrë efikase.

Siç e përmendëm edhe më sipër, pavarësia objektive e gjyqësorit kërkon që KLGj-ja, si organi qeverisës i gjyqësorit të përfshihet në çdo fazë të procesit buxhetor, përfshi këtu edhe atë të zbatimit dhe menaxhimit të fondeve të alokuara. Kjo është arsyeja që ligji i njeh KLGj-së, përgjegjësinë për mbikëqyrjen e shpenzimeve, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të sakta, sipas legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor. Kjo kompetencë i mundëson KLGj-së rishikimin e nevojave financiare gjatë vitit buxhetor, me qëllim rialokim të fondeve bazuar në nevojat, apo bërjen e propozimeve për shtesa buxhetore.

Si administrator i sistemit gjyqësor, KLGj-ja nëpërmjet strukturave të veta përgjegjëse (i) mbledh dhe analizon të dhëna mbi zbatimin e buxhetit dhe të ardhurat e siguruar nga gjykatat, (ii) mbikëqyr e këshillon gjykatat mbi teknikat dhe procedurat e përshtatshme dhe eficiente që lidhen me menaxhimin financiar të tyre, si dhe (iii) kontrollon përdorimin e fondeve që u janë dhënë gjykatave sipas destinacioneve.

Me qëllim një menaxhim efikas dhe uniform të buxhetit në të gjitha hallkat e gjyqësorit, Këshilli duhet të: (i) miratojë standarde të praktikave më të mira dhe objektiva të performancës, në lidhje me administrimin financiar të gjykatave; (ii) sigurojë trajnim për stafin gjyqësor mbi menaxhimin financiar të gjykatave, si edhe (iii) ndërmarrë projekte me synimin për të përmirësuar menaxhimin financiar të gjykatave.

KL Gj-ja ka gjithashtu edhe kompetencat kontrolluese dhe audituese të fondeve buxhetore

të alokuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëpërmjet Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në KLGj duhet të bëjë auditimin dhe monitorimin e përdorimit të fondeve të alokuara për të gjitha gjykatat e vendit, duke filluar nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallëve të para. Është përgjegjësi e kryetarëve të Gjykatës, të mbajnë kontaktet me grupet e auditit, duke u krijuar atyre mundësi për ushtrimin e detyrave.

Lidhur me veprimtarinë e njësisë së administrimit të buxhetit gjyqësor, Këshilli ushtron këto kompetenca: a) miraton projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm të propozuar nga njësia për çdo nivel të gjykatave dhe ia dërgon atë për shqyrtim organit kompetent për shqyrtim dhe miratim, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit përkatës; b) auditon dhe monitoron përdorimin e fondeve të akorduara dhe analizon kërkesat e gjykatave për fonde që mund të lindin gjatë vitit buxhetor.

Kryetari i Gjykatës, mban kontakt me grupet e kontrollit të institucioneve të tjera shtetërore, njihet me qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijon atyre mundësi për ushtrimin e detyrës.

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në KLGj, realizon auditimin e buxhetit gjyqësor. Kjo drejtori ushtron kompetencat e auditimit dhe monitorimit të përdorimit të fondeve të akorduara për të gjitha gjykatat e vendit, duke filluar nga Gjykata e Lartë, e apelit dhe e shkallëve të para.

VIII.1.2 Treguesit e realizimit

Disa konsiderata paraprake:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendos²¹ miratim, ndryshim të destinacionit të fondeve buxhetore.

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit në vijim (KPSAB-ja), si struktura përgjegjëse për hartimin, miratimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik, politikave administrative, financiare dhe buxhetore në funksionin të menaxhimit të mirë e efikas të sistemit gjyqësor në vend, gjatë vitit 2022 ka realizuar 40 mbledhje, në të cilat janë marrë 100 vendime, 88 prej të cilave në fushat përkatëse të veprimtarisë si më poshtë vijon: - 22 në fushën e planifikimit strategjik; - 46 në fushën e administrimit dhe efijencës; 18 në fushën e planifikimit dhe menaxhimit financiar dhe buxhetor; - 2 akte individuale (konfidenciale).

Sa i përket çështjeve të trajtuara lidhur me administrimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore, vlen të theksohet se reagimi i Komisionit ka sjellë efijencë dhe efektivitet. Kjo tregohet edhe nga realizimi i buxhetit për sistemin gjyqësor, në masën 93%, duke reaguar në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë ndaj nevojave të sistemit gjyqësor, në funksion të menaxhimit

21. Në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitin 2023", Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

të fondeve buxhetore me efikasitet dhe efektivitet.

Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar është përgjegjës për përgatitjen e projektbuxhetit të gjykatës, monitorimin e shpenzimeve buxhetore, kryerjen e pagesave dhe çdo transaksioni financiar të parashikuar nga buxheti, si dhe për administrimin e vlerave materiale dhe monetare sipas ligjit.

Nëpunësit të këtij Sektori kryejnë detyrat e përcaktuara në përshkrimin e punës bashkëlidhur kësaj rregullore. Ata mbikëqyren nga Kancelari, dhe raportojnë periodikisht në Këshillin e Gjykatës.

Komisioni është përgjegjës për planifikimin, hartimin, zbatimin dhe administrimin e buxhetit. Komisioni merr pjesë në hartimin e politikave buxhetore, planeve strategjike e dokumenteve të tjerë të nevojshëm për një administrim të mirë e efikas të sistemit gjyqësor shqiptar. Komisioni zhvillon kërkime dhe bën propozime për të siguruar një mirëfunksionim të sistemit të menaxhimit financiar. Komisioni i raporton Këshillit problematikat e evidentuara. Komisioni harton projektvendime, rregullore apo udhëzime të cilat i paraqiten Këshillit për miratim.

Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvillon cikël trajnimesh pilot për nëpunësit civilë gjyqësorë. Trajnimet zhvillohen gjatë periudhave të ndryshme kohore dhe përfshijnë module si vijojnë: hyrje në administrim gjyqësor, etika, burime njerëzore, ecuria e rrjedhjes së çështjes, financë dhe buxhet, marrëdhënie me publikun dhe shkrim dhe arsyetim ligjor. Kurrikulat hartohen nga KLGj-ja me asistencën e projekteve të Organizatave Ndërkombëtare me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe profesionalizimit të administratës gjyqësore.

Struktura e monitorimit në KLGj është përgjegjëse për dorëzimin e të gjitha raporteve për rishikim dhe miratim Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Të gjitha raportet publikohen në faqen zyrtare të Këshillit në internet. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit është përgjegjës për rishikimin e këtij dokumenti strategjik çdo vit për të garantuar përputhshmërinë gjatë punës me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Fondet në dispozicion të Këshillit dhe të gjykatave përdoren për këto qëllime:

- a) për pagat dhe sigurimet shoqërore të anëtarëve dhe personelit të Këshillit, si dhe të gjyqtarëve, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave;
- b) për plotësimin e nevojave për shpenzimet operative të Këshillit dhe të gjykatave, si dhe për veprimtari të tjera gjyqësore;
- c) për ndërtimin ose meremetimin e godinave, si dhe për investime të tjera;
- ç) për mbulimin e shpenzimeve të gjykatave, lidhur me dhënien e ndihmës së detyrueshme juridike në rastet e parashikuara në dispozitat ligjore të veçanta.

Treguesit e realizimit mbi menaxhimin e fondeve publike orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A miraton KLGj-ja standarde të praktikave më të mira, si dhe objektiva të performancës, në lidhje me administrimin financiar të gjykatave?
- A siguron KLGj-ja trajnim për stafin gjyqësor mbi menaxhimin financiar të gjykatave?
- A këshillon KLGj-ja gjykatat mbi teknikat dhe procedurat e përshtatshme dhe eficiente që lidhen me menaxhimin financiar?
- A auditon KLGj-ja përdorimin e fondeve të alokuara për Gjykatën e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallëve të para?
- A mbikëqyr KLGj-ja shpenzimet, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të sakta, sipas legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor?
- A përpunon KLGj-ja përgjatë vitit financiar kërkesa për fonde shtesë apo transferim fondesh mes zërave buxhetore?
- A arsyeton KLGj-ja kërkesat për buxhet shtesë, apo rialokim fondesh të bëra gjatë vitit buxhetor?

VIII.1.3 Metodat e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion: në faqen online të gjykatave (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

Për matjen e treguesve të mësipërm vlerësohet veprimtaria e KLGj-së dhe gjyqësorit në raport me detyrimet që rezultojnë nga Ligji nr. 9936/2008 dhe Ligji nr. 114/2015, si dhe aktet nënligjore që lidhen me procedurat standard të zbatimit, monitorimit dhe auditimit e buxhetit.

Informacion mbi nivelin e zbatimit merret edhe nga analizimi i: (i) raporteve të auditimit të brendshëm (Drejtoria e Auditimit të Brendshëm) dhe të jashtëm në KLGj-së (ii) raporteve të monitorimit periodik të KPSAB (iii) raporteve të KLSH-së (iv) raportimeve të MF mbi nivelin e zbatimit të buxhetit (v) kërkesave për shtesa buxhetore gjatë vitet (vi) kërkesave për transferim apo rialokim fondesh përgjatë vitit buxhetor.

Verifikohet nëpërmjet faqes zyrtare dhe raporteve të KLGj-së, nëse KLGj-ja aplikon standardet e praktikave më të mira, në lidhje me administrimin financiar të gjykatave.

Gjithashtu verifikohet nga të dhënat e marra zyrtarisht nga KLGj-ja numri i trajnimeve për stafin gjyqësor rreth menaxhimit financiar të gjykatave.

Të dhënat: faqe zyrtare e gjykatave, faqe zyrtare e KLGj-së

Burimi i të dhënave: për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar.

VIII.2 Faktori 2 - Informacion mbi emërimin dhe strukturën e pagave të gjyqtarëve

VIII.2.1 Standardi i performancës

Momenti i emërimit të magjistratëve nuk është një proces emërimi formal, por realizohet vetëm pasi KLGj-ja bën sërish kontrollin e pasurisë dhe figurës së kandidatit për gjyqtar. Ky proces do të duhet të realizohet mbi kritere standarde dhe të barabarta për të gjithë kandidatët dhe do të duhet të bëhet brenda një afati të shpejtë kohor, në mënyrë që të mos përbëjë pengesë për hyrjen sa më të shpejtë të gjyqtarëve të rinj në sistem. Vendimet për secilin kandidat duhet të jenë të arsyetuara dhe të bazuara në dokumentacionin e paraqitur, veçanërisht nëse do të ketë raste që KLGj-ja nuk lejon emërimin e kandidatëve²².

Duke iu referuar ligjit nr. 96/2016, emërimet për gjyqtar bëhen nga KLGj-ja bazuar në një procedurë të përcaktuar nga vetë ligji, i cili parashikon një periudhë shpallje dhe informimi për publikun e gjerë.

I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme; b) është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar; c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se:

1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.

2. Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj”. 11. Nga kjo dispozitë kushtetuese identifikohen dy kushte emërimi si magjistrat: “shtetësia shqiptare” dhe “përfundimi i formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, merr vendime edhe sa i përket “Kualifikimit për Emërimin e Kandidatëve të Diplomuar në Shkollën e Magjistraturës”. Pas procedurave të verifikimit, rezultatet e verifikimit për kushtet dhe kriteret ligjore të emërimit si magjistrat, profili gjyqtar, për kushtet e emërimit, për kushtin e shtetësisë shqiptare, për kushtin e përfundimit të formimit fillestar për Magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, për kriteret e emërimit, për kriterin e vlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës, për kriterin e pasurisë, për kriterin e figurës, për kriteret e zgjedhshmërisë vendos kualifikimin ose jo të kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit

22. Në rastin e kandidatit për gjyqtar, F.D, KLGj, me vendimin nr. 253, datë 12.11.2019, vendosi të mos e emëronte, me arsyetimin se kishte probleme me pasurinë e tij, por Gjykata Administrative e Apelit pranoi padinë e bërë nga F.D ndaj KLGj-së dhe vendosi detyrimin e KLGj-së për vijimin e procedurës së emërimit të paditësit.

nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ndërkohe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është ngritur edhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Detyrat e këtij komisioni janë të shqyrtojë kërkesat për emërimë në gjykata, duke paraqitur para Këshillit raportin përkatës shoqëruar me tabelat dhe listën e kandidatëve të pikëzuar. Komisioni ndjek procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata, skemën e delegimit, transferimet e gjyqtarëve, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë, si dhe shqyrton kërkesat për kandidim në funksione drejtuese në gjykata. Komisioni shqyrton kërkesat e Shkollës së Magjistraturës për numrin e magjistratëve të rinj, emërimin dhe caktimin në pozicion të kandidatëve të diplomuar. Komisioni harton projektvendime, rregullore apo udhëzime, të cilat i paraqiten këshillit për miratim.

Struktura e pagës: Paga e magjistratit dhe përfitimet e tjera financiare duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit dhe të përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre.

Paga e magjistratit varion nga shkalla e gjykatës apo prokurorisë ku magjistrati ushtron funksionin, vjetërsia në ushtrimin e funksionit, pozicioni drejtues etj.

Struktura e pagave e magjistrateve është publike, e përcaktuar në ligjin 96/2016 neni 12 i tij dhe janë të detajuara sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave.

VIII.2.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të informacionit mbi emërimin e gjyqtarëve orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A kryhen publikimet e emërimeve të magjistratëve në portalin online të KLGj-së?
- A ka në faqen online të KLGj-së informacion të plotë mbi kandidatin që te publiku i gjerë të njihet online?
- A ka publikime në faqen online të gjykatave ose KLGj-së në lidhje me ndarjen e fushave të kompetencës së gjyqtarëve (civile, penale, administrative)?
- A ka në faqet zyrtare online të Gjykatave publikim apo informacion të qartë dhe të saktë mbi strukturën e pagave?

VIII.2.3 Metoda e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

Një mënyrë tjetër efektive për vlerësimin e treguesve të mësipërm është nëpërmjet sondazheve dhe pyetësorëve, të cilat matin perceptimin e qytetarëve, medias, përdoruesve të gjykatave, mbi shkallën e informacioneve që kanë rreth tyre, dhe se sa e vlerësojnë nivelin e aksesit në kalendarin e seancave gjyqësore.

Të dhënat: faqe zyrtare e gjykatave, faqe zyrtare e KLGj-së.

Burimi i të dhënave: për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar.

VIII.3 Faktori 3 - Aksesimi në informacion dhe praktikat e transparencës lidhur me funksionet juridiksionale të gjyqësorit

VIII.3.1 Standardi i performancës

KL Gj-ja, në mënyrë që të garantojë akses të publikut dhe besim të tij te drejtësia, duhet të bëjë transparencë në mënyrën se si kryen funksionet, si dhe të japë informacion të mjaftueshëm, në mënyrë që qytetarët të kenë një perceptim sa më real për administrimin e drejtësisë.

KL Gj-ja duhet të tregojë transparencë në të gjitha proceset vendimmarrëse të saj, që lidhen me gjyqësorin²³, në mënyrë që publiku dhe vetë gjyqtarët të krijojnë bindjen se këto procese bëhen vetëm në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe në përputhje me ligjin²⁴. Për këtë është e rëndësishme që mbledhjet plenare, ku merren vendimet e KLGj-së të jenë të hapura për publikun, të lejojnë praninë e mediave, shoqërisë civile dhe organizatave të ndryshme monitoruese. KL Gj-ja duhet të publikojë paraprakisht datën, orën dhe rendin e ditës të mbledhjeve, si dhe për një rol më proaktiv, të ftojë përfaqësues nga shoqëria civile apo media për të ndjekur mbledhjet e KLGj-së. Nga ana tjetër, duhet të mundësojë në përputhje me ligjin, publikimin online të regjistrimeve audio të mbledhjeve të Këshillit brenda 24 orëve nga dita e zhvillimit, si dhe të procesverbaleve të mbledhjeve plenare²⁵. Është e rëndësishme që në publikimin e regjistrimit të mbledhjeve dhe procesverbaleve redaktimi i materialit, nëpërmjet fshirjes së referencës në emra, të bëhet në përputhje me ligjin, por edhe me vetë qëllimin që ka publikimi, pa e cenuar në thelb atë²⁶.

Në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2022, ka realizuar rreth 114 mbledhje plenare (ose 13% më shumë se viti që shkoi) dhe ka marrë 562 vendimmarrje, qëllimi kryesor i të cilave ka qenë garantimi i funksionalitetit të sistemit gjyqësor.

Më konkretisht, vendimmarrjet e Këshillit patën në fokus: (i) hartimin e akteve nënligjore

23. KL Gj-ja duhet të garantojë transparencë në proceset që lidhen me (i) financimin e gjyqësorit, (ii) proceset e rekrutimit, përzgjedhjes, emërimit, promovimit, (iii) procedimit disiplinor.

24. Shih Opinion no.10(2007) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë drejtuar Komitetit të Ministrave, Këshillit të Evropës për Gjyqësorin dhe Shërbimet në shoqëri, parag. 50 <https://rm.coe.int/168074779b>

25. Shih nenin 69, pikat dhe 3 të ligjit nr. 115/2016.

26. Shih Neni 69 i ligjit, i cili kërkon që të fshihet çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit. Është e rëndësishme që aplikimi i kësaj dispozite të mbajë në vëmendje dhe respektimin e transparencës së KLGj, me qëllim që të mos cenohet thelbi i saj.

në funksion të përmbushjes së përgjegjësiave ligjore, (ii) realizimin e procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe në Gjykatat e Apelit, (iii) emërimin dhe caktimin në detyrë të magistratëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, (iv) miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve 23, (v) realizimin e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve, (vi) adoptimin e mekanizmave për miradministrimin e sistemit gjyqësor, si dhe (vii) miratimin e akteve të nevojshme për fillimin e zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore.

Nga 562 vendimmarrje të Këshillit, 552 prej tyre janë propozuar nga komisionet e përhershme dhe 10 nga komisionet e përkohshme. Për sa i përket kategorizimit të këtyre vendimmarrjeve sipas përcaktimit ligjor, rezulton se: 10 janë akte të mirëfillta nënligjore, të cilat u botuan në fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë 354 akte individuale, 152 akte kolektive dhe 45 akte rregulla të brendshme dhe 1 udhëzim.

12 vendimmarrje të Komisionit i referohen miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve plenare, në përputhje me detyrimin ligjor që ka Këshilli përkundrejt transparencës në marrëdhëniet me publikun. Përmes faqes së internetit të Këshillit, ky detyrim është përmbushur brenda afateve ligjore të arsyeshme duke kontribuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së punës së KLGj-së përkundrejt qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar mbi veprimtarinë e tij.

Rritja e transparencës dhe efikasitetit për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit përmes përmirësimeve të sistemeve aktuale gjyqësore: ICMIS dhe ARKIT është një dimension i rëndësishëm i veprimtarisë së Komisionit. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2022 janë mundësuar zhvillime të reja, si dhe janë trajtuar 686 kërkesa për mbështetje teknike, ka përfunduar me sukses migrimi i gjithë bazës së të dhënave të 5 gjykatave të mëparshme të apelit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionin të Përgjithshëm mundësuar në kuadër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, si dhe janë përcaktuar rregulla të hollësishme për ndarjen e çështjeve me short.

Një nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun. Kjo iniciativë e Këshillit të Lartë Gjyqësor synon standardizimin e marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median, si dhe rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore.

Në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Dokumentimi i Mbledhjes Plenare”, janë të publikuara regjistrimi audio dhe proceverbali për mbledhjen e diskutimeve i mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Procesverbalin e Mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë të publikuara data, ora e fillimit dhe ora e përfundimit të mbledhjes si dhe rendi i ditës.

VIII.3.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të aksesit në informacion dhe praktikat e transparencës lidhur me funksionet juridiksionale të gjyqësorit orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A janë publike mbledhjet e KLGj-së?
- A e lejojnë praninë e mediave, shoqërisë civile dhe organizatave të ndryshme monitoruese në mbledhjet e KLGj-së?
- A publikohen paraprakisht data, ora dhe rendi e ditës i mbledhjeve ?
- A ftohen përfaqësues nga shoqëria civile apo media për të ndjekur mbledhjet e KLGj-së?
- A publikohen online regjistrimet audio të mbledhjeve të Këshillit brenda 24 orëve nga dita e zhvillimit, si dhe të procesverbaleve të mbledhjeve plenare?

VIII.3.3 Metodatat e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

Një mënyrë tjetër efektive për vlerësimin e treguesve të mësipërm është nëpërmjet sondazheve dhe pyetësorëve të cilat matin perceptimin e qytetarëve, medias, përdoruesve të gjykatave, mbi shkallën e informacioneve që kanë rreth tyre, dhe se sa e vlerësojnë nivelin e aksesit në kalendarin e seancave gjyqësore.

Të dhënat: faqet zyrtare të gjykatave, faqja zyrtare e KLGj-së.

Burimi i të dhënave: për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar.

IX. MONITORIMI I TË DREJTËS PËR AKSES NË VENDIMET DHE PRAKTIKAT E GJYKATËS SË LARTË PËR PALËT NË GJYKIM DHE PALËT E INTERESUARA

IX.1 Faktori 1 - Publikimi i vendimeve të Gjykatës së Lartë

IX.1.1 Standardi i performancës

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë është në majën e piramidës gjyqësore. Ajo siguron dhënien e barabartë dhe të paanshme të drejtësisë për të gjithë qytetarët në vend dhe vendos standardet e një gjykimi të drejtë.

Gjykata e Lartë shqyrton rekursat kundër vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e posaçme të shkallëve më të ulëta, me misionin e vetëm që të sigurojë unifikim dhe zhvillim të mëtejshëm të praktikës gjyqësore.

Gjykata e Lartë i ushtron funksionet gjyqësore të përmes kolegjeve të saj, Kolegji Civil, Kolegji Penal dhe Kolegji Administrativ, Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.

Ashtu si edhe kemi argumentuar më lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor për t'i ardhur në ndihmë publikut në lidhje me transparencën në gjyqësor dhe aksesin e këtyre të fundit në gjykatë ka krijuar faqen e internetit gjykatat.gov.al ku janë të pasqyruara të gjitha gjykatat shqiptare.

Gjykata e Lartë disponon faqen e saj të internetit nga ku i mundëson publikut akses në lidhje me veprimtarinë e saj dhe transparencën gjyqësore. Në faqen zyrtare të internetit *gjykataelarte.gov.al* janë të pasqyruara "Lista e Gjykimeve" në të cilat përfshihen: çështje të ardhura, çështje të shpallura për gjykim, kërkesa për konstatim shkelje afati të arsyeshëm, Kërkesa për pezullim, Revokim, etj. Gjithashtu në këtë faqe janë të pasqyruara Kalendarit i Çështjeve, Vendimet e Gjykatës së Lartë, Rregullat e Reja të Gjykimit në Gjykatën e Lartë, (me ndryshimet të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 29.05.2021).

Një tjetër faktor i rëndësishëm në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është edhe Rubrika e dedikuar Njoftimeve për Median, Njoftime për Publikun, Buletini Informativ.

IX.1.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të publikimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

A është faqja zyrtare në internet, lehtësisht e aksesueshme nga qytetari, dhe e plotë në informacion dhe e përditësuar?

A respektohet afati 30-ditor nga data e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor deri në ditën e zbardhjes së vendimit dhe depozitimit në sekretari?

IX.1.3 Metoda e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar, duke vlerësuar me PO/JO.

Një mënyrë tjetër efektive për vlerësimin e treguesve të mësipërm është nëpërmjet sondazheve dhe pyetësorëve të cilat matin perceptimin e qytetarëve, medias, përdoruesve të gjykatave, mbi shkallën e informacioneve që kanë rreth tyre, dhe se sa e vlerësojnë nivelin e aksesit në kalendarin e seancave gjyqësore.

IX.2 Faktori 2 - Transparenca mbi punën e Gjykatës së Lartë në dhoma këshillimi

IX.2.1 Standardi i performancës

Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

Gjyqtari relator i caktuar me short vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimit të parashikuara në ligj.

Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit.

Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

Palët mund t'i kërkojnë me shkrim relatorit përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

Gjyqtari relator paraqet relacionin duke pasqyruar në të, veç të tjerave, arsyet e përshpejtimin të çështjes, nëse ka, përmbajtjen e vendimit të ankimuar, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, prapësimet e paraqitura në kundërrekurs, shqyrtimin e

fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.

Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor. Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën Njoftim me Shpallje janë të publikuara dhe të aksesueshme lehtësisht Shpallje Publike për efekt njoftimi në të cilin është përcaktuar qartë Regjistri Themeltar i çështjes, palët ndërgjyqëse, si dhe datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore.

Gjithashtu në të njëjtën rubrikë janë përcaktuar edhe Njoftimet për shpallje vendimi ku një kopje e shpalljes së këtij vendimi për efekt njoftimi afishohet pranë ambienteve të Gjykatës së Lartë, si dhe në Portalin Elektronik të Gjykatës së Lartë.

Në çështjet e shpallura për gjykim për shqyrtim në dhomë këshillimi, pasqyrohet lista e çështjeve për gjykim ku janë të përcaktuar anëtarët e trupit gjykues, palët ndërgjyqëse, objekti i mosmarrëveshjes, data dhe ora e gjykimit.

IX.2.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të transparencës mbi punën e Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A ka në faqen online të gjykatës informacion mbi orën dhe datën e zhvillimit të seancave gjyqësore në dhomë këshillimi?
- A respektohet afati 15-ditor për publikimin e njoftimit në ambientet e gjykatës dhe në faqen online të gjykatës?

IX.2.3 Metodat e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

Një mënyrë tjetër efektive për vlerësimin e treguesve të mësipërm është nëpërmjet sondazheve dhe pyetësorëve të cilat matin perceptimin e qytetarëve, medias, përdoruesve të gjykatave, mbi shkallën e informacioneve që kanë rreth tyre, dhe se sa e vlerësojnë nivelin e aksesit në kalendarin e seancave gjyqësore.

Të dhënat: faqe zyrtare online e Gjykatës së Lartë

Burimi i të dhënave: për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës, ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë apo i përditësuar.

IX.3 Faktori 3 - Transparenca në seancat e kolegjeve të Gjykatës së Lartë

IX.3.1 Standardi i performancës

Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës.

Në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Lartë, nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare www.gjykataelartë.gov.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Gjithashtu, në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Gjykata e Lartë vendos në dispozicion të publikut, në faqen e internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Faqja e internetit www.gjykataelartë.gov.al dhe numrave përkatës të telefonit;
- Administrata Gjyqësore, e cila nëpërmjet nëpunësve të sekretarisë gjyqësore dhe arkivit, informon personat e interesuar mbi statusin e dosjes gjyqësore;
- Afishimi i listave të gjyqeve në tabelën përkatëse vendosur në hyrjen e gjykatës;
- Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median.
- Media e shkruar dhe audiovizuale duhet të kontaktojë me këtë sektor për ushtrimin e veprimtarisë së saj në ambientet e Gjykatës së Lartë;
- Vendimet dhe botimi i tyre;
- Sekretaria Gjyqësore e Gjykatës së Lartë, në oraret e caktuar dhe kundrejt pagesës së tarifës përkatëse;
- Buletinet Periodike të Gjykatës së Lartë;
- Konsultimi, krahas burimeve të tjera të mësipërme, i Fletores Zyrtare, për vendimet e Kolegjeve të Bashkuara, që kanë njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore.

IX.3.2 Treguesit e realizimit

Treguesit e realizimit të solemnitetit të seancave gjyqësore orientohen nga përgjigjet që merren nga pyetjet e mëposhtme:

- A ka në faqen online të gjykatës informacion mbi orën dhe datën e zhvillimit të seancave gjyqësore në kolegje të bashkuara?
- A respektohet afati i njoftimit 15-ditor përpara datës së zhvillimit të seancës online të gjykatës?
- Në rast se palët nuk kanë dhënë kontakte elektronike, a merr masa të mëtejshme Gjykata për të siguruar njoftimin e palëve mbi procesin që do të zhvillohet?

IX.3.3 Metodat e matjes

Për matjen e treguesve të mësipërm, mund të merret informacion: në ambientet e gjykatës ose mund të konsultohet faqja online e gjykatës (nëse ka), ku analizohet lloji i informacionit të publikuar, lehtësia e aksesimit të tij, fakti nëse është i plotë, i përditësuar duke vlerësuar me PO/JO.

Një mënyrë tjetër efektive për vlerësimin e treguesve të mësipërm është nëpërmjet sondazheve dhe pyetësorëve të cilat matin perceptimin e qytetarëve, medias, përdoruesve të gjykatave, mbi shkallën e informacioneve që kanë rreth tyre, dhe se sa e vlerësojnë nivelin e aksesit në kalendarin e seancave gjyqësore.

X. EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI

MODULI 1 - 3

Neni 10 i DUDNj-së:

“Çdo njeri ka të drejtë në barazi të plotë për një gjykim të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve dhe detyrimeve të tij dhe për çdo akuzë penale kundër tij”.

Neni 6.1 i KEDNj-së:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”

Neni 41 i Ligjit nr. 98/2016

“1. Administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbimeve të mëposhtme:

a) shërbime gjyqësore, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore, duke përfshirë dokumentimin dhe veprimtari që kryhen nga këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kryesekretarja dhe sekretarët gjyqësorë;

b) shërbime administrative, që përfshijnë financën dhe buxhetimin, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, teknologjinë e informacionit, arkivin gjyqësor, sigurinë, si dhe burimet njerëzore;

c) shërbime mbështetëse, që sigurojnë në mënyrë të veçantë kryerjen e shërbimeve të njoftimeve, dhënien ndihmë trupit gjykues dhe kryesuesit të seancës, si dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me rregullin dhe sjelljen e përshtatshme gjatë seancës gjyqësore, shërbimet e transportit, mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës.

2. Veprimtaritë që duhet të kryhen rregullisht për secilin nga këto shërbime përcaktohen në përshkrimin standard të punës, të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.”

Neni 126 i KPC-së

“Vendimi përfundimtar jepet nga gjykata në përfundim të gjykimit i cili zgjidh çështjen në themel. Vendimi përfundimtar, si dhe vendimet që i japin fund procesit gjyqësor civil të parashikuara prej nenit 127 të këtij Kodi jepen në “Emër të Republikës” dhe përkatësisht duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyra e zgjidhjes së saj.”

Neni 35 i Ligjit nr. 98/2016

“1. Qendra e dokumentacionit bën:

a) sigurimin e publikimit të menjëhershëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;

b) analizën dhe vlerësimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe siguron publikimin e ekstrakteve të vendimeve kryesore, si dhe publikimin e vendimit të plotë;

c) ndjekjen dhe studimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të tjera dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe u jep gjyqtarëve, ndihmësmagjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë jomagjistratë informacion mbi interpretimin e ligjit nga ana e gjykatave.

2. Qendra e dokumentacionit punon nën mbikëqyrjen e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

3. Vendimet e trupave gjykues të Gjykatës së Lartë, bashkë me mendimin e pakicës, publikohen në Buletinin Periodik të Gjykatës, në përputhje me ligjin “Për Qendrën e Botimeve Zyrtare”.

4. Vendimet e Gjykatës së Lartë për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore publikohen në Fletoren Zyrtare të radhës.”

MODULI 4

Neni 5/3 i Ligjit nr. 98/2016

“Seanca gjyqësore është publike, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe ”.

Neni 91/1/a, b)/1 i Ligjit nr. 115/2016

“Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun. Në këtë kuadër, Këshilli kryen detyrat e mëposhtme:

a) krijon, zhvillon, dhe mirëmban një portal elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për qasjen në drejtësi, përfshirë informacion të detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik;

b) bën të mundur që secila gjykatë të ketë hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet dhe t'i lejojë të publikojë në të të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore”.

MODULI 5

Neni 95 i Ligjit nr. 115/2016

“Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe sistemi gjyqësor financohen nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme”

Neni 96 i Ligjit nr. 115/2016

“Në zbatim të kompetencave të parashikuara në nenin 95 të këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor kryen detyrat e mëposhtme: a) ndihmon gjykatat në hartimin e projektbuxheteve të tyre vjetore”.

Neni 34, neni 35 i Ligjit nr. 96/2016

“Çdo vit, deri në fund muajit qershor, Shkolla e Magjistraturës publikon listën e kandidatëve magjistratë, të diplomuar në formimin fillestar gjatë atij viti”.

“I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere:

a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme;

b) është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar;

c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji”.

MODULI 6

Neni 482/1 i KPC

“Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi”

XI. RASTE STUDIMORE

Rasti 1

Përshkrimi i Rastit

Dy individë, shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti James Lazaris dhe zoti Peter Lazaris (“Aplikantët”), trashëguan nga babai i tyre një tokë me sipërfaqe 2 660 metër katrorë dhe një shtëpi me sipërfaqe 101 metër katrorë, të cilat ishin shtetëzuar nga regjimi komunist i dikurshëm. Në vijim, mbi këtë tokë u ndërtua një fabrikë vaji, e cila në vitin 1994 iu shit V.R. si rezultat i privatizimit.

Në vitin 1995, aplikantët ndoqën procedurën pranë ish KKKP Vlorë, dhe u pajisën me vendim për kthimin e tokës në masën prej 335 metër katrorë dhe të shtëpisë. Ndërsa pjesa tjetër e tokës e zënë me fabrikën e vajit u vendos të kompensohet.

Aplikantët paraqitën padi kundër V.R. dhe ish KKKP dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (Rajoni Vlorë) duke kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së privatizimit dhe kthimin e pjesës së tokës së zënë nga fabrika e vajit. Në këtë gjykim ata u përfaqësuan nga avokatët I.D. dhe N.B.

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, si edhe Gjykata e Apelit Vlorë [në datë 19 Nëntor 2004] vendosën në favor të aplikantëve. Avokatët e aplikantëve paraqitën pretendimet dhe ishin prezent në gjykimet e zhvilluara.

Të paditurit paraqitën rekurs përpara Gjykatës së Lartë. Në datë 21 dhjetor 2004, Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë i komunikoi rekursin avokatit I.D., i cili nënshkroi për këtë qëllim.

Në datë 7 korrik 2005, Gjykata e Lartë zhvilloi seancë në mungesë të aplikantëve dhe të përfaqësuesve të tyre, por në prezencë të palëve të paditura të cilët paraqitën edhe pretendimet e tyre verbalisht. Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimeve të dy gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe rrëzimin e padisë. Gjykata e Lartë nuk u shpreh në lidhje me mungesën e aplikantëve në gjykim.

Në datë 28 mars 2006, Gjykata Kushtetuese deklaroi papranueshmërinë e pretendimeve të aplikantëve pa shpjeguar ndonjë arsye.

GjEDNj, pasi shqyrtoi aplikimin e aplikantëve konstatoi se gjykata vendase ka shkelur Nenin 6 të KEDNj-së. GjEDNj ka arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se:

- (i) Në rastet e zhvillimit të seancës gjyqësore, palët duhet të jenë prezent, pasi e drejta për një proces të rregullt e garantuar nga neni 6 i KEDNj-së përfshin të drejtën e palëve për të paraqitur parashtrimet e tyre si i konsiderojnë të përshtatshme për rastin e tyre. Secilës palë duhet t'i ofrohet mundësia për të paraqitur parashtrimet apo pretendimet e veta në një mënyrë që nuk e vendos në disavantazh me palën kundërshtare.
- (ii) Edhe pse në mungesë të njoftimit personalisht të palëve, ato mund të marrin dijeni mbi seancën, duke marrë inisiativën për t'iu drejtuar gjykatës në ambientet e gjykatës ose duke vizituar faqen online të gjykatës, nuk mund të pritët, në mënyrë të arsyeshme, që palët të veprojnë kështu për çdonjërin nga njoftimet që publikon Gjykata e Lartë përgjatë një periudhe 6-mujore, pasi morën dijeni për paraqitjen e rekursit. Edhe nëse pala nuk ka treguar kujdesin e duhur në këtë rast, pasojat që i atribuohen sjelljes së palës dhe që vijnë nga gjykata vendase, duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën apo rëndësinë e pakujdesisë së palës dhe të kenë në konsideratë parimin e përgjithshëm dhe të drejtë të dëgjimit të palës.
- (iii) Identiteti i përfaqësuesve të palës ishte i njohur përmes të dhënave të prokurës së dhënë atij dhe të paraqitur në gjykimet përpara gjykatave të shkallëve më të ulëta. Këto të dhëna gjykata i dispononte në dosjen gjyqësore. Kështu, Gjykata e Lartë nuk mund të thuhet se nuk kishte mundësi efektivisht të informonte Aplikantët ose përfaqësuesit në lidhje me gjykimin.
- (iv) Konsideruar objektin e çështjes si të lidhur me pretendim mbi drejtën e pronësinë mbi tokën, si edhe dëmet e lidhura, autoritetet vendase duhej të kishin treguar kujdes të veçantë për të siguruar përmbushjen e plotë të garancive të Nenit 6 të KEDNj-së.

Lidhja me standardin dhe faktorin

Moduli 4, Faktori 1: Qasja në informacionin publik dhe transparenca në gjyqësor

Kontakti i qytetarit me gjykatat përbën elementin kryesor të qasjes në informacion në këtë rast. Sekretaria gjyqësore duhet të marrë masa dhe të njoftojë, për të gjitha efektet, palën prezent fizikisht, mbi çdo mënyrë të marrjes së informacionit mbi seancën gjyqësore, goftë edhe nëse ky informacion mbi datën dhe orën e seancës nuk është publikuar ende. Gjithashtu, sekretaria gjyqësore duhet të jetë aktive dhe e kujdesshme në këto raste, për të mbajtur në monitorim ecurinë e gjykimeve, në mënyrë që pala të informohet në kohë edhe mbi pritshmërinë e datës së seancës dhe duke vendosur në vëmendje të palës të drejtën për të dhënë kontaktin elektronik në të cilin mund të dërgohet njoftim individual.

Moduli 6, Faktori 6: Transparenca në seancat e kolegjeve të Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë duhet të garantojë përditësimin e listave të publikimit të datave dhe orareve të seancave gjyqësore duke garantuar afatin ligjor prej 15 ditëve përpara seancës, rrjedhimisht të drejtën e palës për të marrë njoftimin.

Edhe në rastet kur është kryer njoftimi i palëve për zhvillimin e seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet shpalljes së listave në faqen zyrtare të gjykatës ose në ambientet e gjykatës, duhet të mbahet megjithatë në vëmendje edhe eventualiteti tjetër, kur gjykata duhet të tregojë të njëjtin kujdes dhe të marrë të gjitha masat që sigurojnë respektimin e të drejtës së palës për të qenë prezent, deri në konsiderimin e shtyrjes së datës së seancës deri sa të kryhet njoftimi i duhur dhe rregullisht, në zbatim të nenit 6 të KEDNj-së.

Referimi në ekstrakte nga legjislacioni

Neni 6.1 i KEDNj-së:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”

Neni 482/3 i KPC

Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

Pyetje :

- *Si duhet të vendoset komunikimi i Gjykatës me palët në këtë rast dhe përse ai merr rëndësi të veçantë?*
- *Cilat janë detyrat specifike dhe konkrete të Sekretarisë së Gjykatës dhe të palëve në këtë rast?*
- *Cila është garancia e ofruar nga ana e Gjykatës për njoftimin e rregullt të palëve?*
- *Deri në çfarë mase shtrihet kjo garanci e njoftimit të rregullt të palëve nga ana e Gjykatës, në kuadër të nenit 6 të KEDNj-së?*

XII. BIBLIOGRAFIA

1. Resource Guide on Strengthening Judicial Integrity and Capacity, UNODC, 2011;
2. Monitorimi i Integritetit Gjyqësor, ISPL, 2019;
3. Rule of Law and Security Sector Governance Indicators Guide, USAID, 2021;
4. Justice Sector Benchmarks User's Guide, ABA/USAID, 2011;
5. Procedural Fairness: A Key Ingredient In Public Satisfaction: A Key Ingredient In Public Satisfaction, A White Paper Of The American Judges Association The Voice Of The Judiciary, by Kevin Burke and Steve Leben. 2007;
6. CCJE Opinion No. 24 (2021): Evolution of the Councils for the Judiciary and their role in independent and impartial judicial systems;
7. www.coe.int/en/web/ccje/-/the-ccje-adopts-opinion-no-24-2021-on-the-evolution-of-the-councils-for-the-judiciary-and-their-role-in-independent-and-impartial-judicial-systems;
8. Deklarata e Stambollit mbi Transparencën Gjyqësore:
https://www.unodc.org/res/ji/import/law_on_administration_of_justice/istanbul_declaration_implementation/istanbul_declaration_implementation.pdf
9. Dokumenti i Komisionit Europian për Efiçencën e Gjyqësorit (CEPEJ): Të matësh cilësinë e drejtësisë: https://rm.coe.int/1680747548#_Toc461720517
10. Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit: shikim mbi jurisprudencën e GjEDNj-së, shtator 2021: <https://www.rolplatform.org/wp-content/uploads/2022/01/independence-and-impartiality-of-judiciary-alb.pdf>
11. Projekti i ri TJENI i GJEDNJ <https://www.coe.int/en/web/national-implementation/tjeni>
12. Kodi i Procedurës Civile
13. Kodi i Procedurës Penale
14. Ligji nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar
15. Ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
16. Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
17. Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”
18. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
19. Udhëzimi nr. 15 datë 13.12.2011 të Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”
20. Ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”
21. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ndryshuar -

22. Ligji nr. 9936/2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar,
23. Ligji nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*
24. Udhëzimi nr. 15 datë 13.12.2011 të Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *“Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”*
25. Urdhri i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6777/5, datë 30.09.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për marrëdhënien e gjykatës me publikun”*
26. Vendim i KLGj-së nr. 211, datë 10.06.2022 *“Për miratimin e raportit vlerësues dhe propozimit të grupit ndërinstitucional të punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”*
27. *“Plani Strategjik të Komunikimit”* për Informimin e Medias dhe Publikut, i miratuar nga KLGj-ja.
28. *“Plani i Komunikimit për Gjykatat 2022-2024”* i miratuar nga KLGj-ja.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore
Monitorimi i transparencës së gjykatave : manual trajnimi për
shoqërinë civile : disponueshmëria e vendimeve gjyqësore dhe
aksesi në dokumentet e gjykatës : praktikat e transparencës në
funksionimin e brendshëm të gjykatës / Instituti për Studimet
Publike & Ligjore. - Tiranë : Muza, 2024.
(Pj.2), ... f. ; ... cm
ISBN 9789928361653

1.E drejta dhe legjislacioni 2.Gjykata 3.Vendime gjyqësore
4.Manuale 5.Shqipëri

34(496.5) (035)